

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR

Për klasën e pestë fillore

Prishtinë, dhjetor 2005

Kryeredaktor

Dr. Fehmi Ismajli

Redaktorë

Mr. Miranda Kasneci

Ramush Lekaj



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT,
ESHKENCËS DHE E
TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF
EDUCATION, SCIENCE &
TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE, NAUKU I
TEHNOLOGIJU

Kabineti I Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbatimi i planit dhe programit për klasën e pestë

NUMËR: MASHT 6 / 2006

DATË: 20.01. 2006

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 6.1 paragrafi (b), si dhe nenit 7.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1

Qëllimi

Qëllim i këtij Udhëzimi Administrativ është zbatimi i Planit dhe i programit mësimor për klasën e pestë si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

Neni 2

Plani dhe programi

Plani dhe programi i ri për klasën e pestë i është bashkëngjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

Zbatimi

- 3.1.** Ky Plan dhe program për klasën e pestë zbatohet nga viti shkollor 2007/2008.
- 3.2.** Me zbatimin e Planit dhe të programit të klasës së pestë shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së pestë të shkollës fillore.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.



Agim Veliu, Ministër

PËRMBAJTJA

Udhëzim administrativ, **3**

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT, **7**

I. Hyrje, **7**

II. Qëllimet, **8**

III. Udhëzime metodologjike, **8**

IV. Vlerësimi, **10**

V. Burimet dhe mjetet mësimore, **13**

VI. Plani i lëndëve mësimore, **13**

VII. Mësimi zgjedhor, **14**

GJUHË SHQIPE, **19**

GJUHË ANGLEZE, **33**

MATEMATIKË, **59**

NJERIU DHE NATYRA, **73**

EDUKATË QYTETARE, **93**

HISTORI, **107**

EDUKATË MUZIKORE, **119**

EDUKATË FIGURATIVE, **131**

PUNËDORE, **141**

EDUKATË FIZIKE DHE SPORTIVE, **151**

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT

I. HYRJJE

Arsimi është fushëveprimtari prirëse e zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike të Kosovës.

Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore, sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, që filloi pas përfundimit të luftës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) po e realizon duke ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit.

Në këtë ndërmarrje me rëndësi historike për zhvillimin dhe për përparimin e shoqërisë kosovare, MASHT synon të ndryshojë pikëpamjet në procesin e ndërtimit të individit me një vizion të qartë për të ardhmen e tij dhe të vendit të tij.

Kjo krijon parakushtet e nevojshme për integrimin e individit dhe të shoqërisë kosovare në lëvizjet politike, në zhvillimet ekonomike, intelektuale, shkencore e teknologjike, si dhe në zhvillimet social-kulturore të vendeve të përparuara evropiane dhe botërore.

Zhvillimi i Planit dhe i programit lëndor mbështet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të nxënit, mjeteve mësimore, metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit.

Grupet punuese profesionale për zhvillimin e planeve dhe të programeve ishin vazhdimisht në rrjedhë të zhvillimeve të reja në arsim dhe në konsultim me ekspertët ndërkombëtarë. Në këtë proces të zhvillimit të planeve dhe programeve, i cili qëndron mbi bazën e strategjisë afatgjatë të MASHT-së, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë UNICEF-i, agjencitë dhe qeveritë e disa shteteve.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar kultivimit të qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit, inkurajimit të nxënësve që të angazhohen në mënyrë të arsyeshme në përmbushjen e kërkesave shkollore, zhvillimit të shkathtë-

sive në jetën e përditshme, gjithmonë duke pasur parasysh veçoritë e zhvillimit fizik dhe psikik në këtë moshë.

Realizimi i qëllimit të këtij Plani dhe programi do të varet nga puna e përkushtuar e mësimitdhënësve, të cilëve edhe u kushtohet ky plan dhe program. Për ta lehtësuar zbatimin e këtij plani dhe programi mësimor, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë do të organizojë kohë pas kohe cikle ligjëratash me mësimitdhënës të udhëhequr nga ekspertë fushash përkatëse me një udhëzim shtojcë të këtij plani dhe programi.

II. QËLLIMET

Plani dhe programi mësimor për klasën e pestë ka për qëllim:

- vazhdimin e ndërtimit të vlerave shpirtërore të nxënësit, konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathëtsive në ndërtimin e së ardhmes së tyre.
- Inkurajimin e nxënësve për të marrë nismë e veprim të pavarur në rrethin familjar e më gjerë, duke respektuar rregullat themelore të sjelljes në grup.

Grupet punuese për zhvillimin e planeve dhe të programeve në përshtatshmëri me përmbajtjen i kanë zgjedhur objektivat e përgjithshëm dhe specifike për sendërtimin e qëllimeve të lartshënuara nga të cilat në mënyrë të qartë janë përcaktuar edhe rezultatet e pritura në përfundim të klasës së pestë.

III. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet kombinuar, të jenë sa më të larmishme, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat dhe teknikat e mësimitdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë llojet e mësimitdhënies. Mësimitdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara për të arritur rezultate sa më të larta gjatë procesit mësimor.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda dhe teknika të ndryshme:

- shpjegimi dhe sqarimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- të mësuarit problemor;
- diskutimi (debati);
- puna në grupe;
- demonstrimi dhe interpretimi;
- teknika e të menduarit kritik;
- stuhi mendimesh (brainstorming);
- vetëhulumtimi (kërkimi).

Për tema të caktuara që karakterizohen me informacione të bollshme gjejnë zbatim edhe ligjërata ndërvepruese e kombinuar me veprimtari praktike.

Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses: mësimi në natyrë, ekskursione të ndryshme studimore, vizita institucioneve të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate të pritshme.

IV. VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shcallë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në objektivat e dijes (rezultatet e pritshme) të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore siç janë:

- përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- zbatimi i instrumenteve përkatëse të matjes në përputhje me qëllimin në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm.

IV. 1. Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetëtori (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i mbështetur në kritere dhe në objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje):
 - me përgjigje alternative të shumta;
 - me përgjigje të hapura të shkurtra;
 - me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

Çdo shkollë vendos standardet apo kriteret me anën e së cilave përcaktohet shkalla e arritshmërisë në fund të procesit mësimor për klasën e pestë.

IV. 2. Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë njëren prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë);
- mirë (arritje mesatare);
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

Shkalla e përfitimit të arritshmërisë varet drejtpërdrejt nga standardet e arritshmërisë (shiko tabelën më poshtë) të cilat mbështeten në:

Objektivat e përgjithshëm	Arritje shumë e lartë 90%	Arritje e lartë 80%	Arritje e kënaqshme 60%	Arritje e kufizuar 40%	Arritje e pamjaftueshme
<i>Njohja e lëndës</i>	Aftësi shumë e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi mesatare në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi jo e mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.
<i>Të kuptuarit e proceseve shkencore</i>	Aftësi shumë e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak- pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak - pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kënaqshme e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak- pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kufizuar e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore	Aftësi e pamjaftueshme e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore
<i>Të menduarit kritik</i>	Aftësi e lartë e të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e të menduarit kritik në situata komplekse, si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e kufizuar e të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.		
<i>Shkathësitë manovruese</i>	Shkallë e kënaqshme e përfitimit në shkathësitë manovruese.			Shkallë e ulët e përfitimit (disa) në shkathësitë manovruese.	

V. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive e këtij plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi. Deri tash burim kryesor informimi ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse. Nëse mungon një tekst përkatës për lëndën përkatëse, mësimdhënësit dhe nxënësit kanë mundësi të shfrytëzojnë tekste të ndryshme nga klasat paraprake dhe vijuese për lëndën përkatëse si dhe materiale të tjera plotësuese me qëllim sigurimi të një baze shkencore për dituritë dhe përvojën e fituar.

Krahas teksteve të ndryshme shkollore sugjerohet të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

- doracakë, atlase, broshura;
- gazeta, revista profesionale dhe shkencore;
- fotografi, posterë, afishe, skema, diagrame, harta, tabela;
- modele, figura, makete;
- fotoslajde, filma, videokaseta;
- programe të kompjuterëve, interneti, CD-të etj.

Është kompetencë e arsimtarit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon, shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

VI. PLANI I LËNDËVE MËSIMORE

Nr.	Lëndët mësimore	Numri i orëve gjatë vitit	Përqindja
1	Gjuhë shqipe	185	21.15%
2	Gjuhë angleze	74	8.69%
3	Matematikë	185	21.15%
4	Njeriu dhe natyra	74	8.69%

5	Edukatë qytetare	74	8.69%
6	Histori	74	8.69%
7	Edukatë muzikore	37	4.34%
8	Edukatë figurative	37	4.34%
9	Punëdore	37	4.34%
10	Edukatë fizike dhe sportet	74	8.69%
11	Mësimi zgjedhor mund të organizohet nga: lëndë apo kurse të reja (p.sh. edukim qytetar, etikë, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, TIK, mbrojtja e mjedisit jetësorë apo çkado tjetër që është joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin.	74	8.69%
	Gjithsej:	851	100.0

VII. MËSIMI ZGJEDHOR

Quhet kështu sepse nxënësit e zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit. Lënda, kursi apo veprimtaria për mësimin zgjedhor mund të sugjerohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ose në mbështetje të kërkesës së nxënësve, prindërve, arsimtarëve, apo kujtdo tjetër nga komuniteti. Në mënyrë të veçantë, do të duhej të konkurrojnë arsimtarët e papunë me projekt komplet (lëndën, kursin apo veprimtarinë dhe planin, programin, tekstin dhe mënyrën e realizimit).

Mësimi zgjedhor mund të organizohet nga:

Lëndë apo kurse të reja (p.sh. edukimi qytetar, etika, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit, mbrojtja e mjedisit jetësor apo çka do tjetër që është joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin.

Lënda, kursi apo veprimtaria për mësim zgjedhor duhet të zgjatë jo më pak se tre muaj.

Për lëndën, kursin apo veprimtarinë duhet të deklarohen më se paku 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës (në qoftë se klasa ka më shumë se një paralele) e në qoftë se klasa ka vetëm një paralele, atëherë është e

nevojshme që për lëndën, kursin apo veprimtarinë të deklarohen gjysma e paraleles - në mënyrë që të mund të organizohet mësimi zgjedhor.

Për mësimin zgjedhor, në mbështetje të kërkesave të të interesuarve, vendosin organet profesionale të shkollës në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit para fillimit të vitit shkollor. Për mënyrën e deklarimit të nxënësve, të prindërve apo të të interesuarve të tjerë dhe kohën kur ata e bëjnë këtë, vendosin organet e shkollës, por gjithsesi e tërë procedura duhet të kryhet para fillimit të vitit shkollor.

Planet dhe programet për mësimin zgjedhor i harton shkolla në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit dhe profesionistë të lëmenjve përkatës nga komuniteti (në qoftë se ka të tillë).

Mësimi zgjedhor kur të aprovet nga organet profesionale të shkollës e ka statusin e mësimit të rregullt, më të vetmin përjashtim që mësimi zgjedhor do të vlerësohet me notë përshkruese (jonegative).

GJUHË SHQIPE

(5 orë në javë, 185 orë në vit)

HYRJE

Gjuha është element kryesor i identitetit individual dhe përbën një nga tiparet themelore të një kombi. Mësimi i gjuhës është proces i cili asnjëherë nuk përfundon, prandaj edhe kërkon përkushtim të madh, sepse ka peshë të veçantë, sidomos në shkollë ngase kryen funksion të dyfishtë: si lëndë kryesore mësimore dhe si gjuhë mësimore për lëndët e tjera shkollore.

Mësimi i gjuhës në shkollë synim kryesor ka krijimin e vetëdijes për përvetësimin e saj gradual, për rëndësinë dhe peshën e saj, duke kuptuar se përmes gjuhës krijohen dhe përcillen mesazhe dhe nocione themelore për kuptimin e vetvetes e botës shoqërore si dhe ndikimin e fuqishëm që luan ajo në zhvillimin e gjithanshëm të individit, si në fushën emocionale, intelektuale, ashtu edhe në atë sociale e fizike.

Programi i gjuhës shqipe për klasën e pestë është konceptuar, jo vetëm si vazhdimësi e programeve të klasave paraprake, jo vetëm si përfundim i mësimin të gjuhës për shkollën fillore, por kryesisht si konceptim e lidhje me programin e klasës së gjashtë të shkollës së mesme të ulët.

Programi i gjuhës për këtë klasë është organizuar përmes këtyre shkathësive të komunikimit: **dëgjimit, të folurit, leximit dhe shkrimit** brenda të cilave janë vendosur tërësitë tematike e në kuadër të tyre përmbajtjet programore dhe rezultatet e pritshme.

Përvetësimi dhe sistemimi i njohurive kryesore për sistemin e gjuhës shqipe, për tekstet letrare e tekstet joletrare, për zbatimin e rregullave të komunikimit, për kulturën e afrimitetit me të tjerët, për formimin e kulturës së përgjithshme individuale etj., janë disa nga kërkesat themelore të këtij programi që ndikojnë dhe bëjnë të mundshëm zhvillimin dhe ngritjen e individit.

QËLLIMET

Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e pestë ka për qëllim që nxënësi:

- Të zhvillojë aftësinë e të dëgjuarit informativ dhe të dëgjuarit aktiv në grup në kuptimin e marrjes së informatave dhe të mesazheve;
- Të përvetësojë dhe të zgjerojë shkathtësitë dhe mënyrat e komunikimit, komunikimin verbal e joverbal;
- Të zhvillojë të folurit aktiv individual e në grup në funksion të përvetësimit të gjuhës standarde dhe të thellojë njohuritë themelore gjuhësore;
- Të kuptojë dhe të dallojë të lexuarit e teksteve letrare e joletrare e të përvetësojë teknikat e leximit;
- Të zhvillojë të shkruarit funksional dhe të shkruarit subjektiv (vetjak);
- Të përvetësojë të shkruarit në funksion të përvetësimit të gjuhës, të leksikut;
- Të përvetësojë të shkruarit në funksion të drejtshkrimit dhe të pikësimit.

OBJEKTIVAT

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të njohë

- Tekste letrare dhe joletrare;
- Fjalët e ndryshueshme e të pandryshueshme, tipat dhe llojet e fjalive;

Të kuptojë

- Tekste letrare dhe joletrare;
- Fjalët e ndryshueshme e të pandryshueshme, gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë, fjalitë e përbëra dhe ligjëratën;

Të zbatojë

- Njohuritë e fituara gjuhësore fonetike e gramatikore;
- Njohuritë e fituara mbi modelet e shkrimit;
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare e joletrare.

Të analizojë

- Tekste letrare dhe joletrare;
- Fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra.

Vlerat, qëndrimet, formimi

- Të menduarit e pavarur për atë që dëgjon, shpreh, lexon dhe shkruan;
- Kulturë e sjelljes personale - qëndrimi, sjellja, toleranca, mirë-kuptimi,
- Komunikimi, vullneti, bashkëpunimi, ndihma reciproke etj.

SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

I. TË DËGJUARIT

II. TË FOLURIT

III. TË LEXUARIT

IV. TË SHKRUARIT

I. TË DËGJUARIT

TËRËSITË TEMATIKE

I.1. Të dëgjuarit informativ

I.2. Të dëgjuarit efektiv

I.3. Të dëgjuarit e teksteve joletrare dhe letrare

I.4. Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës

I.5. Të dëgjuarit në funksion të zgjerimit të leksikut

II. TË FOLURIT

TËRËSITË TEMATIKE

- II.1. Të folurit informativ
- II.2. Të folurit aktiv në grup
- II.3. Të folurit në funksion të teksteve letrare dhe joletrare
- II.4. Të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës
- II.5. Të folurit në funksion të zgjerimit të leksikut
- II.6. Të folurit joverbal

III. TË LEXUARIT

TËRËSITË TEMATIKE

- III.1. Të lexuarit e teksteve joletrare
- III.2. Të lexuarit e teksteve letrare
- III.3. Të lexuarit në funksion të teknikave të leximit
- III.4. Të lexuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës
- III.5. Të lexuarit në funksion të zgjerimit të leksikut

IV. TË SHKRUARIT

TËRËSITË TEMATIKE

- IV.1. Të shkruarit funksional
- IV.2. Të shkruarit personal imagjativ
- IV.3. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të gjuhës
- IV.4. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të leksikut
- IV.5. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të drejtshkrimit
- IV.6. Të shkruarit në funksion të pikësimit

I. TË DËGJUARIT		
TËRËSITË TEMATIKE	PËRMBAJTJET	REZULTATET E PRITSHME
I.1. Të dëgjuarit informativ	Regjistrin e merr informata dhe mesazhe të ndryshme nga: mësimdhënësi, mjedisi familjar dhe ai shkollor, radio, televizioni, shtypi, interneti, kinemaja, teatri etj.	Dëgjon, merr dhe i kupton informatat e mesazhet nga të tjerët.
I.2. Të dëgjuarit afektiv në grup	Prezantime gojore të moshatarëve dhe të rriturve dhe prezantime të xhiruara për: biseda zyrtare e jozyrtare, ngjarje, rrëfime, histori të shkurtra dhe tekste popullarizuese si: loja, sporti, muzika, natyra, shëtitja, vizitat, udhëtimet, vikendet, festat etj.	Dëgjon aktivisht folësit, diskuton, reagon, bashkëbisedon; ndihmon veten dhe bashkëbiseduesit në sqarimin e mesazheve që merr duke dhënë përgjigje në grup; zbaton rregullat themelore të komunikimit; krijon pavarësinë e të shprehurit; fiton kulturë afrimiteti me të tjerët.
I.3. Të dëgjuarit e teksteve joletrare dhe teksteve letrare	Tekste joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues shkencor, ekologjik, etik, edukativ etj. tekste të folura, të lexuara, të xhiruara dhe të ekranizuara. Tekste letrare – format e thjeshta letrare; fjalë të urta, gjëgjëza, legjenda, përrallëza, përralla etj. Poezi, prozë, dramë.	Dallon tekstet joletrare nga tekstet letrare; dallon poezinë nga proza; përjeton dhe heton ritmin, rimën, vargun dhe strofën e poezisë; Kupton dhe njeh veçoritë e prozës si tema, ngjarja, personazhet, toni rrëfyes etj.; veçoritë e dramës si monologu, dialogu, aktet etj., radiodrama, drama televizive etj.
I.4. Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës	Gjuha e folur dhe organizimi i saj në nivel tingujsh, fjalësh, fjalish, ligjëratash dhe tekstesh; të shqiptuarit e tingujve zanorë e bashkëtingëllorë, rrokjeve dhe fjalëve; fjalë, ligjërata dhe intonacioni.	Dëgjon dhe kupton mënyrën dhe nivelin e organizimit të gjuhës së folur dhe të shkruar; kupton dhe dallon të folurit e thjeshtë (të rrethit), dialekti dhe të folurit e standardizuar.

I.5. Të dëgjuarit në funksion të zgjerimit të leksikut	Zgjeron dhe pasuron fjalorin personal me: fjalë të reja, me shprehje të veçanta, me frazeologjizma, me terma nga fushat e ndryshme etj.	Pasuron fjalorin personal si ndikues i drejtpërdrejtë në rritjen e aftësive shprehëse, komunikuese, saktësinë dhe qartësinë.
II. TË FOLURIT		
TËRËSITË TEMATIKE	PËRMBAJTJET	REZULTATET E PRITSHME
II.1. Të folurit informativ	Përmes akteve të të folurit: prezanton veten, familjen; shpreh një ide, mendim, mesazh, deklaratë, propozim, kundërshtim etj., për probleme të ndryshme.	Angazhon vetveten që si folës të imponojë të dëgjuarit të folurit e prerë, duke përdorur shprehje që kanë forcë e ngarkesa emocionale dhe etike.
II.2. Të folurit aktiv në grup	Prezantime gojore në tema të caktuara : rrëfime, histori të shkurtra, tekste popullarizuese si nga fusha e sportit, muzikës, filmit, aktiviteteve, informacioneve të ndryshme etj.	Në mënyrë aktive reagojnë, argumentojnë, debatojnë, ndihmojnë për të dhënë përgjigje në grup; analizojnë dhe vlerësojnë idetë kryesore, zhvillojnë aftësitë e të folurit në grup, duke respektuar rregullat e komunikimit dhe nxjerrin përfundime.
II.3. Të folurit për tekste joletrare dhe letrare	Tekste joletrare të karakterit njohës, edukativ, dokumentar, shkencor, zyrtar; Tekste letrare : fjalë të urta, legjenda, këngë, përrallëza, përralla, poezi dhe prozë.	Dallon dhe njihet tekste joletrare nga tekste letrare; Kupton dhe komenton format e thjeshta letrare, zbërthen tekste letrare, dallon tekstin lirik, rrëfyes, dramatik dhe gjuhën poetike.
II.4. Të folurit në funksion të të përvetësimit të gjuhës	Gjuha e teksteve joletrare dhe e teksteve letrare; fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme, fjalët figurative, fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra, fjalët dhe fjalitë me kuptim mohues, pohues,	Dallon gjuhën e teksteve joletrare nga gjuha e teksteve letrare; njihet dallimet në mes fjalisë së thjeshtë dhe asaj të përbërë dhe brenda tyre fjalët e ndryshueshme (emri, mbiemri, përemri, folja, numërori) dhe fjalët e pandryshueshme (ndajfolja,

	urdhërues, pyetës etj.	lidhëza, pjesëza etj.); ndërton të folurit me fjalë dhe fjali mohuese, pohuese, urdhëruese, pyetëse etj.
II.5. Të folurit në funksion të zgjerimit të leksikut	Leksik apo zgjerim i fjalorit personal me: fjalë të reja, terma të veçantë, fjali, shprehje të veçanta, fraza.	Zgjeron fjalorin dhe kupton fjalë, terma, shprehje e fraza që ndihmojnë të shprehurit më të mirë, më ekspresiv dhe më elokuent.
II.6. Të folurit joverbal	Të folurit joverbal përmes ndjenjave, mimikës së fytyrës, mimikës së veprimit, shikimit.	Përvetëson të folurit joverbal përmes veçorive e shprehive të ndjenjave dhe të emocioneve; Përvetëson të kuptuarit e ndjenjës joverbale përmes mimikës së fytyrës, mimikës së veprimit (gjesteve) dhe shikimit.
III. TË LEXUARIT		
TËRËSITË TEMATIKE	PËRMBAJTJA	REZULTATET E PRITSHME
III.1. Të lexuarit e teksteve joletrare	Tekste joletrare : tekste të shkurtra (zyrtare e jozyrtare si p.sh., lajmërim, kërkesa, letra, shpallje, urime, falënderime, përshëndetje, formularë, reklama etj.). Tekste profesionale, dokumentare dhe edukative (si p.sh., profesioni, sporti, loja, puna, natyra, vendi, ngjarje interesante nga e kaluara, festa, shëtitje, vizita etj.).	Lexon me zë apo në heshtje dhe zbërthen tekste të shkurtra zyrtare dhe jozyrtare (dallon porosinë dhe adresantin, titullin, hyrjen, datën etj.). Gjatë dhe pas leximit kupton natyrën e teksteve, i parafrazon, i interpreton dhe i identifikon sipas natyrës së shkrimit dhe të tematikës së tyre.
III.2. Të lexuarit e teksteve letrare	Format e thjeshta letrare: Fjalë të urta, përrallëza, përralla, legjenda. Poezia (ritmi, vargu, strofa, rima, personifikimi, hiperbola, litota, epiteti); Proza	Identifikon dhe kupton natyrën e formave të thjeshta letrare, sidomos të përrallëzës, përrallës dhe legjendave- mënyrën e të rrëfyerit, personazhet tipike, motivet, temat etj. Lexon dhe kupton

	(personazhet letrare, ngjarja, koha dhe hapësira, autori-rrëfyesi, tema, motivet realiteti, imagjinata etj.); Tekste dramatike apo të dramatuara (monologu, dialogu, akti, skena, regjisori etj.).	natyrën e poezisë, përjeton ritmin dhe tonalitetin e saj, vargun, ritmin, rimën. Njohin figurativitetin poetik, analizon poezinë dhe kupton personifikimin, hiperbolën, litotën, epitetin. Gjatë dhe pas leximit dallon prozën e shkurtër dhe prozën e gjatë, identifikon autorin, personazhin kryesor e dytësor, temën, ngjarjen- përcakton kohën dhe hapësirën e saj, dallon realitetin e saj nga fikcioni. Njeh konstruktin e tekstit dramatik- ngjarjen, aktet, personat kryesorë dhe anësorë, dialogun, monologun. Lexon tekstin dramatik, përjeton dhe vlerëson atë dhe e krahason me shfaqjen teatrale (skena, folësit, kostumet, muzikën, etj.).
III.3. Teknikat e leximit	Të lexuarit pa zë - në heshtje; të lexuarit në zë: të lexuarit e rrjedhshëm- qartë, të lexuarit shprehës, të lexuarit gradual, recitimi, interpretimi (zëri, diksioni, intonacioni, ndalesat, shenjat e pikësimit, tempi i leximit, timbri, theksi logjik, mimika e fytyrës dhe mimika e veprimit.	Dallon dy forma leximi: leximin në heshtje apo pa zë dhe leximin në zë. Përvetëson qartësinë dhe rrjedhshmërinë e gradualitetin e të lexuarit. Me ushtrime përvetëson gradualisht të lexuarit shprehës dhe interpretativ, duke respektuar shenjat e pikësimit, ndalesat, theksat logjike, ritmin, tempin, diksionin, intonacionin.
III.4. Të lexuarit dhe përvetësimi i gjuhës	Teksti dhe fjalia; ligjëratat e drejtë dhe të zhdrejtë; veprime brenda fjalisë; llojet e fjalive, format pohore dhe mohore të fjalive; kryefjala, kallëzuesi, kundrinori, rrethanori, përcaktori, ndajshkrimi; emri, mbiemri, përemri, folja, numërori, ndajfolja, lidhëza, pjesëza; fjalia e thjeshtë, fjalia e përbërë.	Kupton dallimin e tekstit dhe fjalisë e ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë; kupton fjalinë dhe jofjalinë, njeh llojet e fjalisë (pyetëse, nxitëse, dëftore etj.) dhe format e tyre; kupton kryefjalën e shprehur me përemër dhe folje, kallëzuesorin e kryefjalës; dallon gjymtyrët e dyta të fjalisë: kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë, rrethanorin e vendit, mënyrës

		dhe kohës, përcaktorin dhe ndajshkrimin; dallon dhe njeh fjalët e ndryshueshme: emrin (llojet, numrin, gjininë, trajtat dhe lakimin), mbiemrin (llojet, përshtatja me emrin, me numrin etj.), përemrin – llojet, lakimin, foljen (numri, veta, mënyra, zgjedhimi), numërori- llojet; Kupton fjalët e pandryshueshme ndajfoljen e vendit, mënyrës, kohës dhe sasisë, llojet e lidhëzave dhe pjesëzat; kupton përbërësit e fjalisë së thjeshtë dhe të fjalisë së përbërë.
III.5. Të lexuarit dhe përvetësimi i leksikut	Fjalë të reja, terma, shprehje gjuhësore, sinonime, antonime, homonime dhe shprehje frazeologjike.	Gjatë të lexuarit aktiv përvetëson dhe zgjeron fjalorin vetjak, dallon dhe kupton sinonimet, antonimet, homonimet dhe shprehjet frazeologjike. Praktikon përdorimin e fjalorit.
IV. TË SHKRUARIT		
TËRËSITË TEMATIKE	PËRMBAJTJET	REZULTATET E PRITSHME
IV.1. Të shkruarit funksional	Kopjon: tekste të shkurtra e të përcaktuara; modelimi: ftesa, këshilla, udhëzime të thjeshta, njoftime; plotëson: skeda, formularë, fatura, reklama; shkruan: pyetje, anketa, intervista, citime, informacione të shkurtra, letra zyrtare, raporte të thjeshta etj.	Kopjon, përkatësisht përshkruan saktë dhe qartë tekste apo pjesë të ndryshme; mbi bazën e modeleve shkruan ftesa, udhëzime, këshilla, njoftime; njeh dhe plotëson me shkrim skeda, formularë të thjeshtë, fatura, reklama etj.; formulon, shtron dhe shkruan pyetje, anketa, intervista, letra zyrtare dhe raporte të thjeshta.
IV.2. Të shkruarit subjektiv (vetjak)	Shkrime krijuese: letra, poezie, tregime, biografi, autobiografi, ditar,	Krijon dhe shkruan për nevoja vetjake, përmes përdorimit të modeleve, letra, biografi,

	korrespondencë, kujtime, mendime për vepra, film, shfaqje teatrale, ekspozitë, artikuj për gazeta shkolle, tekste të thjeshta për situata të ndryshme jetësore etj.	autobiografi, poezi, tregime, ditar, korrespondenca, artikuj të thjeshtë dhe shfaq me shkrim mendime për një film, shfaqje, ekspozitë dhe për situata të ndryshme jetësore.
IV.3. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të gjuhës	Tekst, paragraf, fjali, grupe fjalësh; ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë, tipat e fjalive, fjali të thjeshta dhe të përbëra, grupin e kryefjalës dhe të kallëzuesit, gjymtyrët e dyta të fjalisë, emrin, mbiemrin, përemrin, foljen, numërorin, ndajfoljen, lidhëzat, pjesëzat, parashtesat, prapashtesat etj.	Dallon dhe shkruan struktura të tilla gjuhësore si tekst, paragraf, fjali, grupe fjalësh, ligjëratë; shkruan dhe kupton llojet e fjalisë së thjeshtë dhe të përbërë; pjesët kryesore të fjalisë dhe grupet plotësues të saj; shkruan dhe kupton fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme.
IV.4. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të leksikut	Leksiku: fjalët në kuptimin e parë dhe të figurshëm, terma, sinonime, antonime, homonime, shprehje të veçanta, frazeologjizma etj.	Dallon dhe shpjegon kuptimet e fjalëve (kuptimin e parë dhe të figurshëm), shkruan dhe përdor fjalë me shumë kuptime, kupton dhe përdor sinonimet, antonimet dhe frazeologjizmat.
IV.5. Të shkruarit në funksion të drejtshkrimit	Saktësia e fjalëve, lexueshmëria, hapësira, ndarja, shkronja e madhe, shkronjat ë, q, ç, xh, gj etj. apostrofi, zbatimi i rregullave të formimit të njëjësit dhe të shumës etj.	Saktësia e fjalëve një e shumërrrokëshe të thjeshta e të përbëra, lexueshmëria e shkronjave dhe fjalëve, hapësira ndërmjet fjalëve dhe rreshtave, ndarja e fjalëve në rrokje dhe në fund të rreshtit, përdorimi i shkronjës së madhe, përdorimi i saktë dhe me vend i shkronjave ë, q, ç, xh, gj në fillim, në trup apo në fund të fjalës, kupton dhe përdor saktë apostrofin etj.
IV.6. Të shkruarit në funksion të pikësimit	Shenjat e pikësimit: pika, pikëpyetja, presja, pikëpresja, thonjëzat, viza, apostrofi etj.	Përdor saktë shenjat e pikësimit në dialog, në ligjëratën e drejtë, në llojet e fjalive, në fjalitë e përbëra etj.

INTEGRIMI NDËRLËNDOR DHE NDËRPROGRAMOR

Gjuha është mjet themelor komunikimi dhe funksioni i saj i dyfishtë në shkollë si lëndë dhe si gjuhë mësimore ofron mundësi të shumta të ndërthurjes me lëndët e tjera sidomos me:

- Edukatë muzikore;
- Edukatë qytetare;
- Edukatë figurative
- Punë dore;
- Histori;
- Gjuhë joamtare.

Pesha dhe rëndësia e lidhjes ndërlëndore përbën një resurs shumë të favorshëm e ndikues në zhvillimin dhe në formimin e tërësishëm të personalitetit të secilit nxënës. Është e domosdoshme sidomos në këtë kohë të zhvillimit të kompjuterizimit dhe internetit që mësimdhënësit të punojnë dhe të bashkëpunojnë sa më shumë që është e mundur në realizimin e integritimit ndërlëndor.

Janë të shumta përmbajtjet dhe temat nga fushat e ndryshme që mund të trajtohen, zhvillohen dhe realizohen si pjesë ndërprogramore. Rëndësia e tyre kryesisht përcaktohet nga mundësitë e sigurimit të literaturës dhe peshës që mund të ketë mosha dhe koha e realizimit. Lidhjet ndërprogramore janë kryesisht të fushave si:

- Të drejtat e njeriut - fëmijëve;
- Edukimi shëndetësor;
- Ekologjia dhe mjedisi;
- Barazia gjinore etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin e Planit dhe programit të Gjuhës shqipe, mësimdhënësi është kompetent për zgjedhjen e metodave dhe të teknikave të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Metodat dhe teknikat e përzgjedhura nga mësimdhënësi, duhen përshtatur aftësive dhe njohurive të mëparshme të nxënësve, nevojave dhe kërkesave të tyre, mjedisit (shkollës, klasës) dhe materialit mësimor.

Gjatë mësimit është e rëndësishme të përdoren teknika dhe strategji të shumëllojshme për të përkrahur stilet e ndryshme të nxënies së nxënësve. Për realizimin me sukses të metodave dhe të teknikave mësimit, gjatë planifikimit, duhet t'i përshtatet mënyrës se si mësojnë nxënësit, cilat teknika mundësojnë realizimin e përmbajtjes mësimore dhe të objektivave të caktuar.

Përdorimi i metodave dhe i teknikave të reja të mësimit sugjeron nxënësin në qendër të aktiviteteve të të nxënësve, pastaj bashkëpunimin e nxënësve, duke u mbështetur në modelin e mësimit nga njëri-tjetri. Ky lloj i të mësuarit do të jetë më i suksesshëm. Nëse nxënësit, përfshihen më shumë në veprimtari të ndryshme gjatë të nxënësve, edhe rezultatet do të jenë më të mira.

Mësimit duhet të dijë se ka edhe disa veçori që ndikojnë në mësimit, p.sh., qëndrimi, përvoja, rezultati, qartësia dhe llojshmëria në mësimit, përdorimi i ideve të nxënësve etj.

LITERATURA

- Tekstet që do të hartohen në bazë të këtij programi
- Tekstet e mëparshme që përmbajnë këtë materie
- Tekste të tjera alternative

ENGLISH LANGUAGE CURRICULUM

(2 hours per week, 74 in total)

INTRODUCTION

The program of English language will emphasize the importance of experiencing language in context. Learners' background knowledge, skills and attitudes will be used as means of developing communicating abilities. As the learners develop communication skills, they also increase their linguistic accuracy and develop language learning strategies.

In the English language program learners will acquire various kinds of knowledge, skills and attitudes about:

1. interpreting, expressing and negotiating meaning (communication).
2. Sounds, written symbols, vocabulary, structure and discourse (language).
3. Cognitive, socio-cognitive and meta-cognitive process (general language education).
4. Patterns of ideas, behaviours, manifestations, cultural artefacts and symbols (culture).

Acquiring the language incorporates communication skills such as listening, speaking, reading, writing, viewing and showing. Learners develop these communication skills by using knowledge of the language, including grammar, and culture, communication and learning strategies, technology, and content from other subject areas to socialise, to acquire and provide information, to express feelings and opinions. Knowledge of other cultures, connections to other disciplines, comparisons between language and cultures, and community interaction all contribute to and enhance the communicative language learning experience, but the communication skills are the primary focus of language acquisition.

THE GOALS

English as a foreign language will be introduced for the first time in the early grades of primary education in Kosova. The purpose of this early introduction in the school curriculum is to enable the students to reach a working language competence after completion of upper secondary education for both further education and career. Learning English as a foreign language throughout their pre-university education will enable learners to develop the knowledge, skills, and attitudes they need to communicate in English, in a variety of school, travel, leisure and job-related contexts. English as a foreign language will extend the cultural experience of pupils and will facilitate the integration of our society in the European integration processes.

The overall approach during the initial years of English language learning experiences will be focusing on the non-analytical aspect (learning as communication through interaction without in-depth study of linguistic elements). As they advance in their language experience and competence, the focus will shift towards more analytic approach, but always keeping a balance between the two.

In this grade, however, learners will be able to:

- a) **Participate** in various language experiences that will enable to engage in situations dealing with: (1) school, people around us, weather, animals, holidays and celebrations., (2) **understand** a series of simple oral and written statements in a controlled and structured context, and (3) **express** their thoughts by producing simple oral and written messages of a few statements in a controlled context.
- b) **Identify** the presence of English (speaking) individuals and groups and concrete facts about English cultures;
- c) **Understand** and **use** orally and in writing the sound – symbol system, vocabulary and word order in simple structures.

The scope of grade five English Language curriculum

<p>Communication Enable learners to develop their language skills and gain ability and some confidence for effective communication</p>		
<p>Listening General Objective: Learners should be given the opportunity to listen to the teacher, peers and media (audio, tapes, videos)</p>		
<p>Specific objective</p>	<p>Suggested language activities</p>	<p>Attainment targets</p>
<p>Learners should be able to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Recognise and respond to familiar words and basic phrases concerning themselves and their families; • Listen to stories, descriptions, instructions and directions and respond to them; • Understand and respond to short statements and questions related to areas of most immediate personal relevance, e.g. very basic and familiar information, shopping and immediate environment (residence, school, etc); • Understand the gist of short, clear and simple messages; • Recognise and respond to basic phrases concerning themselves and their families; • Demonstrate understanding of simple, clearly spoken language such as simple stories, high-frequency commands, and brief instructions when dealing with familiar topics; • Identify and explain events illustrated in pictures; 	<ul style="list-style-type: none"> • Listen and repeat; • Listen and do; • Listen and guess; • Listen and draw; • Listen and fill in charts; • Matching activities; • Role play; 	<p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Understand simple classroom commands • Understand short statements and questions • Understand phrases related to familiar topics and familiar information • Understand short passages made up of familiar language - including instructions, messages and dialogues • Express opinions and make choices; • Express and respond to thanks; • Express good wishes; • Except offers; • Respond with single words or short phrases, to what they see

<ul style="list-style-type: none"> • Understand short sentences when listening and respond orally with learned materials; • Listen to, enjoy and respond to stories, poem and songs; • Produce learned words, phrases, and short sentences when listening; 		and hear;
<p>Speaking: General Objective: Learners should be given the opportunity to speak in a variety of situations and for different age appropriate purposes related to their interests</p>		
Specific objective	Suggested language activities	Attainment targets
<p>Learners should be able to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Discuss and talk about the everyday activities by using familiar words and expressions; • Produce simple sentences involving repetition or lists; • Use simple phrases and short sentences to describe where they live and people they know; • Describe in simple terms their family and other people, living conditions and their interests; • Take part in short conversations that include past and present actions and events; • Respond briefly, with single words or short phrases, to what they see or hear; • Try to express personal responses, such as likes, dislikes and feelings; • Demonstrate ability to obtain basic information and communicate needs; 	<ul style="list-style-type: none"> • Matching activities; • Singing rhymes; • Role play; • Pronunciation of words; 	<p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Respond briefly, with single words or phrases, to what they see and hear; • Name and describe people, places and objects; • Use short phrases to express personal responses (likes, dislikes, and feelings); • Provide information in response yes/no questions; • Speak about things around them; • Ask for help and permission by using familiar words and phrases; • Use simple phrases and sentences to describe in simple terms their family and other people, living

<ul style="list-style-type: none"> • Share information on their ideas and feelings; • Identify specific time and locations • Express emotions, feelings, preferences, ideas using familiar words and expressions; • Use appropriate words to name and describe things and events. 		<ul style="list-style-type: none"> • conditions, their interests; • Show some understanding of messages found on pictures, signs, posters.
<p>Reading General objective: Learners should be given the opportunity to read simple texts for different purposes</p>		
<p>Specific objective</p>	<p>Suggested language activities</p>	<p>Attainment targets</p>
<p>Learners should be able to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Recognize the beginning and the end of sentences; • Understand single words presented in clear script in a familiar context • Recognize familiar words in new texts; • Read aloud short, simple texts; • Understand short texts and dialogues, made up of familiar language, printed in books; • Understand short informal letters; • Follow short, written instructions, especially if they contain pictures; • Read and understand everyday signs and notices in public places, such as streets, restaurants, school; 	<ul style="list-style-type: none"> • Read short texts; • Read and match the pictures; • Read and act; • Read and write; • Read and draw; 	<p>Learners can:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Read and understand single words presented in a familiar context; • Read and follow short, simple written instructions; • Read and understand short dialogues, made up of familiar language; • Read and follow short simple personal letters, simple messages, e.g. emails and postcards; • Read and follow short, written instructions, especially if they contain pictures; • Read and understand everyday signs and notices in public places, such as streets, restaurants, school.

Writing		
	<p>e veprimeve 2.3. Barazimet dhe jobarazimet</p>	<p>mëdhenj natyrorë; leximi dhe shkrimi i numrorëve të tillë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlera e shifrës sipas vendit që zë, klasat dhe rendet e numrave. • Rrumbullakimi i numrave natyrorë në dhjetëshe, qindëshe, mijëshe, dhjetëmijëshe dhe qindëmijëshe të plota. • Krahasimi dhe renditja e numrave të mëdhenj; paraqitja e tyre në boshtin numerik. • Numrat tekë dhe çiftë. • Vargje të numrave natyralë. • Veprimet (e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit) me numra të mëdhenj; paraqitjet grafike të veprimeve të tilla. • Barazime dhe mosbarazime të thjeshta. • Fuqitë. • Shprehjet numerike; Emërtimi i elementeve në veprimet llogaritëse (mbledhorët-shuma; i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi; faktorët, prodhimi; i 	<ul style="list-style-type: none"> • Të kryejë zbritjen e numrave prej 1-1000000 me kalim, përkatësisht me prishje të dhjetëshe, qindëshe dhe mijëshe; • Të krahasojë dhe të renditë numrat e mëdhenj, duke i paraqitur në boshtin numerik dhe duke përdorur shenjat <, =, >, ...; • Të kuptojë nocionin e vargut të numrave natyralë; • Të kryejë shumëzimin dhe pjesëtimin e numrave të mëdhenj. • Të zgjidhë ekuacionet dhe inekuacionet e formës $a \pm x = b, a \pm x < b, a \pm x > b, x \cdot a = b, a \neq 0, x \cdot a < b, a \neq 0, x \cdot a > b, a \neq 0, a : x = b, x \neq 0, a : x < b, x \neq 0, a : x > b, x \neq 0, a : x = b, x \neq 0, a : x < b, x \neq 0, a : x > b, x \neq 0, x : a = b, a \neq 0, x : a < b, a \neq 0, x : a > b, a \neq 0$; dhe t'i zbatojë ato në zgjidhjen e problemeve praktike. • Të jetë në gjendje t'i emërtojë (mbledhorët-shuma; i zbritshmi,
--	--	--	---

		<p>pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi, mbetja).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vetitë e veprimeve. • Përparësitë e veprimeve llogaritëse. • Numrat racionalë. Thyesat (përsëritje dhe përforsim i njohurive paraprake për thyesat). Mbledhja dhe zbritja e thyesave me emërues të njëjtë. Mbledhja dhe zbritja e thyesave me emërues të ndryshëm duke i shndërruar ato në thyesa të barabarta me emërues të njëjtë. <p>Pjesa e një numri ($\frac{2}{3}$ e 12).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numrat romakë prej 1 (I) deri në 100 (C) 	<p>zbritësi, ndryshimi, faktorët, prodhimi, i pjesëtueshmi, pjesëtuesi, herësi, mbetja).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë thyesat më të vogla dhe më të mëdha se një; thyesat që paraqesin të njëjtin numër dhe të krahasojë thyesat me emërues të njëjtë dhe me numërues të njëjtë. • Të kryejë veprimet me thyesa të cilat kanë emërues të ndryshëm; • Të jetë në gjendje të shkruajë numrat romakë I deri në C.
<p>3. Gjeometria dhe matjet</p>	<p>3.1. Drejtëzat 3.2. Format gjeometrike 3.3. Matjet</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Matjet e gjatësive dhe njësitë; shndërrimi i njësive të tilla shumëmbështetëse në njësi njëmbështetëse. • Matja e masave dhe njësitë; 	<ul style="list-style-type: none"> • Të kryejë matjen e gjatësive të shprehur me anë të njësive mm, cm, dm, m dhe të kuptojë njësitë dkm, hm dhe km. • Të kryejë matjen e masave të

		<p>shndërrimi i njësive të tilla shumëmbërshe në njësi njëmbërshe.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësitë për matjen e lëngjeve, kohës dhe të hollat; shndërrimet e njësive të tilla (nga ato më të mëdha në ato më të vogla). • Matja e sipërfaqeve (syprina e sipërfaqes) njësitë matëse mm^2, cm^2, dm^2, m^2; shndërrimet e njësive në njëra-tjetrën. • Matja e trupave (vëllimet e trupave); njësitë matëse mm^3, cm^3, dm^3, m^3; • Rrafshi. • Pozita reciproke e drejtëzës, rrethit dhe sipërfaqes rrethore (qarkut). • Shumëkëndëshat; trekëndëshi brinjënjëshëm (barabrinjës); drejtkëndëshi; katrori; pesëkëndëshi dhe gjashtëkëndëshi i rregullt; Shënimi i shumëkëndëshave të 	<p>shprehur me anë të njësive gr, dkg, hg, kg;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kryejë matjen e lëngjeve; • Të kryejë matjen e sipërfaqeve me anë të njësive matëse mm^2, cm^2, dm^2, m^2; • Të kryejë matjen e vëllimit të trupave të shprehur me njësitë matëse mm^3, cm^3, dm^3, m^3; • Të dallojë pozitat reciproke të drejtëzës dhe rrethit (drejtëza kalon jashtë rrethit; e pret rrethin në dy pika; e takon rrethin në një pikë); • Të dallojë pozitat reciproke të drejtëzës dhe qarkut (drejtëza kalon jashtë qarkut; e pret qarkun sipas një korde); • Të jetë në gjendje t'i vizatojë si dhe t'i identifikojë kulmet dhe brinjët e shumëkëndëshave të rregullt (trekëndëshit brinjënjëshëm, katrorit, gjashtëkëndëshit të rregullt) • Të bëjë matjen e perimetrave të shumëkëndëshave të tillë;
--	--	---	---

		<p>mësipërm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Perimetrat e shumëkëndëshave (pa përdorim të formulave) (si shumë e gjatësive të brinjëve të tyre). • Syprina e sipërfaqeve shumëkëndëshe të mësipërme me matje (pa formula). • Trupat qoshorë (këndorë) dhe trupat e rrumbullakët. Kubi, kuadri dhe rrjetat e tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë trupat qoshorë nga ata të rrumbullakët si dhe të vizatojë rrjetat e tyre;
<p>4. Përpunimi i të dhënave</p>	<p>4.1. Përpunimi i të dhënave</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimi dhe shënimi i të dhënave. • Paraqitja e të dhënave me tabela, shtylla, pjesë të qarkut dhe diagrameve të ndryshme. • Leximi i tabelave dhe diagrameve të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të paraqesë të dhënat me anë të tabelave, shtyllave dhe t'i lexojë ato. • Të krahasojë të dhënat e paraqitura në tabela ose diagrame.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Shkolla duhet të shërbejë për ngjalljen dhe për ruajtjen e interesimit të fëmijëve për matematikën dhe gradualisht ta zhvillojë atë.

- Mësimi i matematikës asnjëherë nuk guxon të jetë abstrakt dhe verbal, sepse matematika në thelb edhe ashtu vepron me kuptime dhe relacione abstrakte. Duhet që sa më shumë të ofrohet duke u shërbyer me lojëra, eksperimente dhe situata reale nga jeta e përditshme.
- Mënyra e të nxënësve të dijes duhet të zhvillohet në formë të një spiraleje, sepse veprimet dhe strukturat matematike nuk është e mundur që për një herë dhe në tërësi të kuptohen. Do të ishte mirë që çdo herë të lidhen dhe gërshetohen tërësitë e vogla të përmbajtjeve në tërësi më të mëdha në atë mënyrë që duke futur përmbajtjen e re të përvetësohen dhe përforcohen sa më shumë përmbajtjet paraprake.
- Motivimi është çelës i të mësuarit të matematikës. Andaj, mjeshtëria e mësimit për motivimin e nxënësve që të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike është me rëndësi të posaçme. Kjo arrihet me zgjedhjen e ushtrimeve të përshtatshme të cilat nxisin të menduarit logjik të nxënësit.
- Në klasën e pestë të avancohen shkathtësitë e nxënësve për një llogaritje më të saktë gjatë veprimeve me numra dhe me thyesa si dhe të krahasimit të tyre. Andaj, detyrë e mësimit është që të gjejë mënyrën dhe të zgjedhë teknikat përkatëse të mësimit. Këtë mund ta arrijë me mësimin e individualizuar, punën në grupe të vogla etj.
- Duhet patur kujdes që gjatë ushtrimeve, nxënësve të stimulohen të zgjidhin detyra konkrete nga jeta e përditshme, sa herë që një mundësi e tillë ekziston. Në këtë mënyrë nxënësve do të kuptonin në vazhdimësi rolin e matematikës. Po qe se është e mundur, do të ishte mirë të ofrohen sa më shumë variante të zgjidhjes së detyrave.
- Qëllimi i të mësuarit të matematikës nuk është në arritjet rutinore, të mësuarit mekanik të fakteve ose të veprimeve, por përvetësimi me themel i materies. Duhet të kihet parasysh që fondi i njohurive dhe shkathtësive të arritura gjithmonë të jetë në dispozicion të nxënësve.

- Duhet të zgjidhen ushtrime të përshtatshme që të zhvillohet intuita në shkallën e nevojshme për të lëvizur gjithmonë një hap përpara.

Për të arritur rezultatet optimale në fushën e mësimdhënies së matematikës, rëndësi të jashtëzakonshme luan përgatitja profesionale e mësuesit, hartimi i programit të mirë, i teksteve të mira, trajnimi i mirë i mësimdhënësve si dhe përdorimi i metodave dhe teknikave përkatëse të mësimdhënies në pajtim me kushtet dhe me rrethanat në të cilat zhvillohet mësimi.

VLERËSIMI

Vlerësimi përfshin tërë veprimtarinë e cila shërben për të gjykuar mbi shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore dhe standardet e arritshmërisë të saktësuara me program.

Nivelet e arritshmërisë

Shkalla e arritshmërisë të nxënësve vlerësohet duke u mbështetur kryesisht në tri nivele:

Niveli I. - Përfshin arritshmërinë minimale, që d.m.th., paraqet minimumin e domosdoshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë nxënësit. Pra, paraqet kufirin e poshtëm (të lejueshëm) të përvetësimit të përmbajtjes programore e që në përqindje do të shprehej me 40% të materialit të zhvilluar. Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet me ndihmën e mësimdhënësit me anë të një numri të kufizuar metodash, i arsyetojnë faktet e thjeshta matematike me ndihmën e mësuesit si dhe komunikojnë për njohuritë matematike duke pasur gjithmonë këtë ndihmë.

Niveli II. - Paraqitet me kufijtë e rezultateve të shprehur në përqindje (50%-80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike me ndihmën e kufizuar të mësimdhënësit, me anë të një numri jo të madh të strategjive dhe metodave, me disa gabime apo me mangësi të vogla.

Niveli III. - Është niveli më i lartë apo niveli i avancuar (maksimal) i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (mbi 80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, në mënyrë të pavarur. Zgjidhin probleme matematikore me metoda të ndryshme, analizojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara në mënyrë të pavarur dhe saktë, me gjuhë të qartë dhe rrjedhshmëri logjike.

Procedura e vlerësimit

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me standardet e vendosura. Është e kuptueshme se vlerësimi duhet të ndjekë qëllimet arsimore, objektivat mësimorë, objektivat e vlerësimit. Vlerësimi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash në të cilat duhet të përfshihen këto elemente

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- vlerësimi i ndihmesës gjatë punës në grup;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- testet për një grup temash të caktuara;
- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;
- estet në fund të gjysmëvjetorit;
- testet në fund të vitit etj.

Në fund të vitit duhet të nxirret nota përfundimtare, e cila fitohet duke nxjerr mesataren e vlerësimeve.

Lidhjet ndërlëndore (ndërkulikulare)

Matematika në klasën e pestë ndërlidhet me:

- **Gjuhën amtare** - “përktimi” i shprehjeve matematike nga gjuha e rëndomtë në gjuhën matematike dhe anasjelltas;
- **Artet e bukura** - vizatimi i vijave të drejta të lakuara, të hapura, të mbyllura dhe figurave të ndryshme gjeometrike;

- **Edukatën fizike dhe sportet** - orientimi në hapësirë (lëvizjet majtas, djathtas, para, pas; kërcimet lart, larg etj.; matjet e ndryshme);
- **Punë dore** - ndërtimi i figurave dhe trupave të ndryshëm gjeometrikë nga kartoni, plastelina, argjila etj., si dhe ndërtimi i rrjetave të trupave të tillë.

NJERIU DHE NATYRA

(2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJJE

Lënda **Njeriu dhe Natyra** që do të mësohet në klasën e pestë është vazhdimësi e lëndës me të njëjtin emër që ka filluar të mësohet në klasën e tretë dhe të katërt, si lëndë e integruar e shkencave të natyrës: biologjisë, kimisë, fizikës, dhe gjeografisë. Në kuadër të kësaj lënde, nxënësit do të njihen me natyrën që na rrethon, lëvizjet e trupave, bashkëveprimet e tyre, vetitë, përbërjen, strukturën, kërkesat e njeriut për shfrytëzimin e të mirave materiale nga natyra, ushqimin, burimet e energjisë dhe ruajtjen e mjedisit jetësor.

QËLLIMET

Programi i lëndës **Njeriu dhe Natyra** në klasën e pestë ka për qëllim:

- të zhvillojë aftësi të nxënësit për të njohur natyrën, objektet e saj, mjedisin jetësor dhe ruajtjen e tij;
- të krijojë vetëdije për unitetin material të të gjithë trupave në natyrë dhe lëvizjen e vazhduar të tyre;
- të kultivojë shprehi dhe të fitojë shkathtësi për vrojtime, matje, arritje në përfundime të sakëta të ligjshmërive natyrore, ndërlidhje të tyre dhe punë të pavarur në zgjidhjen e problemeve konkrete;
- të formohet si personalitet, stabil dhe vetëkritik, i qëndrueshëm dhe i gatshëm për bashkëpunim me mësimdhënës në shkollë dhe jashtë saj dhe i aftë në ballafaqim me sfidat e jetës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të njohë:

- fakte, terma dhe koncepte lidhur me kërpudhat, organet për ekskretim riprodhim dhe ndijore, ndërtimin dhe llojlojshmërinë e bimëve mjekësore, shtazëve kurrizore dhe mjediseve të ndryshme jetësore;
- përbërjen e lëndëve, vetitë dhe shndërrimet e tyre;
- lloje të ndryshme të lëvizjeve dhe të bashkëveprimeve në natyrë;
- proceset dhe dukuritë natyrore në rrethinë dhe më gjerë;

Të kuptojë:

- fakte, terma dhe koncepte lidhur me kërpudhat, organet për ekskretim riprodhim dhe ndijore, ndërtimin dhe llojlojshmërinë e bimëve mjekësore, shtazëve kurrizore dhe mjediseve të ndryshme jetësore;
- që lënda ndodhet kudo dhe paraqitet në vartësi nga kushtet natyrore, në gjendje të ngurtë, të lëngët, të gaztë etj;
- disa lloje të energjisë dhe format e bartjes së saj;
- disa procese natyrore të cilat e krijojnë dhe e ndryshojnë mjedisin natyror në rrethinë dhe më gjerë (relievi, moti dhe klima).

Të zbatojë:

- njohuritë e ndërtimit të qenieve të gjalla dhe njeriut, mjediseve jetësore dhe botës së gjallë;
- metoda të filtrimit, dekantimit, avullimit, sitjes, kristalizimit etj., për ndarjen e përzierjeve;
- përdorimin e lëndëve ushqyese, higjienike dhe shëndetësore në jetën e përditshme;
- njohuritë e fituara për ndërtimin e qarkut të thjeshtë elektrik;
- veglëritë themelore për matje të gjatësisë, masës, vëllimit, kohës dhe të temperaturës;
- përdorimin e të dhënave grafike, skicave, planeve , hartave dhe aerofotografive.

Të analizojë:

- njohuritë dhe kuptimin e koncepteve për ndërtimin e kërpudhave, njeriut, shtazëve kurrizore dhe bimëve mjekësore
- që toka, ajri dhe uji natyror janë përzierje të lëndëve të ndryshme të rëndësishme për jetë;
- përbërjen e lëndëve të ndryshme;
- dukurinë e përhapjes së dritës në mjedise dhe reflektimin e saj nga sipërfaqet e rrafshta;
- disa procese natyrore në atmosferë, hidrosferë, korën e Tokës dhe në biosferë.

Të sintetizojë:

- dy e më shumë lëndë për të përfuar lëndë të reja e me veti të ndryshme;
- vetinë e përbashkë të bashkëveprimit të trupave në natyrë.

Të vlerësojë:

- rolin e natyrës në jetën dhe në veprimtarinë e njeriut;
- shfrytëzimin e proceseve natyrore për ngritjen e cilësisë të jetës së njeriut;
- rëndësinë e pasurive natyrore për jetën e njeriut, shfrytëzimin dhe ruajtjen e mjedisit;

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve	%
I. Qeniet e gjalla dhe proceset jetësore	1. Veçoritë e qenieve të gjalla 2. Bimët dhe kafshët 3. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	24	32.43
II. Lënda dhe energjia	1. Lënda dhe vetitë e saj 2. Shndërrimet e lëndës	17	22.97
III. Proceset fizike	1. Forca dhe lëvizja 2. Elektriciteti, magnetizmi dhe drita	18	24.32
IV. Toka dhe Gjithësia	2. Rrethina, Toka, Dielli, Hëna dhe planetët	15	20.27
Tërësisht		74	99.99

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
Qeniet e gjalla dhe proceset jetësore	Veçoritë e qenieve të gjalla	<ul style="list-style-type: none"> ❑ Kërpudhat Myku dhe antibiotikët Kërpudhat e ngrënëshme dhe helmuese ❑ Sistemet e organeve të njeriut Sistemi nervor dhe organet ndijore. Organet për ekskretim-dhe riprodhim ❑ Zhvillimi individual i njeriut Fazat e zhvillimit individual të njeriut Njeriu dhe shëndeti 	<ul style="list-style-type: none"> ❑ Përshkruan veçoritë e kërpudhave me të cilat ato dallohen prej bimëve ❑ Përshkruan mënyrën se si nga myku është përfituar antibiotiku penicilinë. ❑ Dallon veçoritë e kërpudhave helmuese dhe të ngrënëshme. ❑ Emërton pjesët e qelizës nervore dhe sistemit nervor qendror. ❑ Emërton organet ndijore dhe lidhjen funksionale të tyre me Sistemin Nervor Qendror. ❑ Përshkruan konceptin ekskretim-tajim. ❑ Emërton organet për ekskretim dhe përshkruan rrugën e urinës prej veshkës deri në mjedisin e jashtëm. ❑ Emërton organet për riprodhim të të dy gjinitë të njeriut. ❑ Emërton fazat e zhvillimit individual të njeriut dhe përshkruan në veçanti fazën e pubertetit. ❑ Vlerëson rolin e higjienës trupore për shëndetin dhe ndikimin negativ të 	<p>Me artin figurativ lidhur me pararqitjen vizuale dhe modelimin me materiale të ndryshme të natyrës dhe gjallesave të ndryshme.</p> <p>Me teknologjinë informative (INTERNET) faqe interneti për fëmijë për plotësimin dhe zgjerimin e njohurive lidhur me natyrën.</p>

		<ul style="list-style-type: none"> ❑ Mjediset jetësore Mjedisi jetësor i livadheve të tipit të savanave Mjedisi jetësor i shkretëtirës Mjedisi jetësor i pyjeve tropikale të shiut Mjedisi jetësor i kënetës Mjedisi jetësor i detit-oqeanit. ❑ Shtazët e rrezikuara në botë dhe te ne. ❑ Ndotja e ujit dhe e tokës 	<ul style="list-style-type: none"> ❑ Përshkruan veçoritë themelore të mjediseve jetësore të savaneve, shkretëtirave, pyjeve tropikale të shiut, kënetës dhe detit. ❑ Emërton organizmat shtazorë tipikë të secilit mjedis jetësor të përmendur më lart. ❑ Përshkruan shkaqet e rrezikimit të shtazëve të ndryshme nga zhdukja. ❑ Emërton disa nga shtazët të cilat janë të rrezikuara për t'u zhdukur në botë dhe te ne. ❑ Emërton burimet e ndryshme të ndotjes së ujit dhe të tokës. ❑ Përshkruan pasojat e ndotjes së ujit dhe të tokës për shëndetin e njeriut dhe të gjallesave të tjera. 	
II. Lënda dhe energjia	II. 1. Lënda dhe vetitë e saj	1. Grupimi dhe klasifikimi i lëndëve <ul style="list-style-type: none"> - Lëndët e ngurta - Lëndët e lëngëta - Lëndët e gazta - Lëndët e pastra dhe përzierjet-tretësirat 	Nxënësit do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajnë ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet lëndëve, drurit nga qymyri, gurit nga hekuri, ujit nga lëngjet, avullin e ujit nga tymi, sheqerin, kripën nga tretësirat ujore të tyre, mermerin e bardhë nga graniti etj., me anë të shqisave. - Të klasifikojnë materialet në bazë të lëndëve përbërëse, pamjes, fortësisë etj., 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjuhë shqipe Për të folur dhe shkruar sa më bukur dhe pa gabime ▪ Punë dore Gjatë punëve praktike me

			<p>(plastikë, metal, qelq, gomë, letër tekstil etj.);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojnë përdorimet e lëndëve sipas vetive të tyre. - Të formojnë tretësira ujore të kripës së gjellës, sheqerit etj. - Të dallojnë ujinë e pastër nga uji i detit, shiut, burimit etj. - Të analizojnë se ajri është përzierje e gazrave të ndryshëm dhe lëndëve të tjera (oksigjen, gaz karbonik, azot, avull uji etj.), toka, ushqimi është përzierje e lëndëve të ndryshme. - Të vlerësojnë rëndësinë e ujit si tretës dhe jetën e përditshme. - Të demonstrojnë disa metoda për ndarjen e përzierjeve në përbërës. - Të dallojnë përzierjet mekanike nga tretësit. - Të identifikojnë metodat ndarëse të lëndëve të përzierjet mekanike dhe të tretësirat. - Të demonstrojnë se tretja e substancës së ngurtë në ujë ka një kufi dhe ndikimin e temperaturës në tretje. - Të vlerësojnë rëndësinë praktike të ajrit dhe për frymëmarrje. 	<p>materiale të ndryshme (letër, dru, plastikë, pëlhura të ndryshme, etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Edukatë qytetare Vetëdijësimi për ruajtjen e shëndetit dhe mjedisit jetësor ▪ Art figurativ Përdorimin e lëndëve të ndryshme gjatë vizatimeve, ngjyrosjeve dhe modelimeve të ndryshme (lapsi grafit, ngjyrat, plastelina,
--	--	--	---	--

	<p>II. 2. Shndërrimet e lëndës</p>	<p>2. Shndërrimet e lëndës në vartësi të faktorëve të ndryshëm.</p> <p>- Ndryshime të kthyeshme dhe të pakthyeshme</p> <p>3. Toka burim i mineraleve dhe të mirave të tjera materiale</p> <p>Metalet: hekuri, bakri, alumini, plumbi etj. - Materialet ndërtimore: guri gëlqeror, gëlqerja, argjila, çimentoja etj. Lëndët e djegshme: të ngurta, të lëngëta dhe të gazëta.</p> <p>4. Përpunimi i lëndve të ndryshme mundë të shkaktjnë ndotjen e mjedisit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të tregojnë se lëndët mund të ndryshojnë formën nëse në to ushtrohen forca të ndryshme mekanike si: shtypje, tërheqje etj. - Të demonstrojnë shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës (ndryshime të gjendjes fizike të ujit në vartësi nga temperatura: i lëngët, i ngurtë dhe i avullt; tretja e sheqerit në ujë dhe djegia e tij. - Të vlerësojnë shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme nga aspekti i rëndësisë jetësore: shëndrrimi i lëndëve të djegshme në energji, nxehtësi, përdorimi i tretësirave për ushqim, për qëllime mjekësore etj. - Të analizojnë qarkullimin e ujit në natyrë si proces i rëndësishëm në biosferë. - Të përshkruajnë se metalet dhe mineralet e ndryshme janë pasuri tokësore dhe nëntokësore e vendit. - Të identifikojnë disa nga metalet më të rëndësishme për jetën siç është: hekuri, bakri, alumini, plumbi etj. - Të analizojnë disa nga veçoritë dalluese të metaleve. - Të përshkruajnë proceset e ndryshme teknologjike të përfutimit të metaleve nga mineralet e nxjerra nga toka, përpunimin 	<p>etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Matematikë Njohja e numrave natyrorë gjatë matjes dhe njehsimeve të madhësive të ndryshme (temperaturës, gjatësisë, masës, vëllimit) dhe hartimit të grafikëve dhe tabelave.
--	---	---	---	--

			<p>dhe përdorimin e metaleve në jetën e përditshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të vlerësojnë rëndësinë e disa mineraleve (guri gëlqeror, mermeri, rëra, argjila, etj.) për materiale ndërtimore. - Të përshkruajnë pasuritë e vendit me minerale të ndryshme. - Të dallojnë lëndët e djegshme sipas gjendjes agregate të tyre. - Të vlerësojnë rolin e lëndëve të djegshme për jetën e përditshme. - Të analizojnë rëndësinë e lëndëve të djegshme si burime të energjisë, të nxehtësisë dhe si lëndë të para për industri, farmaci etj. - Të përshkruajnë që gjatë proceseve për përfitim të lëndëve të ndryshme ndotet mjedisi jetësor. - Të vlerësojnë problemet e ndotjes së mjedisit (me kimikate, plehra, e lëndë të tjera) që dëmtojnë shëndetin e njeriut. - Të ndërjegjësohen se për mjedis të shëndetshëm merita u takon edhe shkollarëve dhe komunitetit më të gjerë të shkollës. - Të respektojnë rregullat (normat) e mënjanimit të hedhurinave në vende të 	
--	--	--	---	--

			<p>caktuara, të klasifikuara sipas llojit të ndotësve (qelq, metale, plastikë dhe mbeturinave të tjera).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajnë mundësinë e shfrytëzimit të hedhurinave d.m.th., përpunimin e tyre (riciklim) për nevoja të jetës (energjetikë, industri, bujqësi etj.). - Të mbrojnë mjedisin duke mbjellur drunj, lule dhe duke i rritur sipërfaqet e gjelbëruara (në shkollë, shtëpi dhe vende të tjera). 	
III. Proceset fizike	III. 1 Forca dhe lëvizja	<ul style="list-style-type: none"> • Duke lëvizur në natyrë trupat kryejnë punë. • Në natyrë trupat kanë energji, prandaj mund të kryejnë punë. • Njeriu shfrytëzon disa lloje burimesh të nxehtësisë. • Disa trupa në natyrë kryejnë lëvizje lëkundëse. • Në jetën e përditshme krijojmë dy lloje valësh. • Trupat në natyrë bashkëveprojnë në mes veti. • Trupat mund të zhyten ose 	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë shembuj kur trupat kryejnë punë si: në rastin e tërheqjes, shtyrjes apo ngritjes. • Të gjejë shembuj të paraqitjes së llojeve të ndryshme të energjisë në mekanikë dhe kalimin nga një lloj i energjisë në tjetrin. • Të dallojë disa lloje burimesh të nxehtësisë dhe të përshkruajë shembuj të kalimit të nxehtësisë nga trupi i nxehtë në trup të ftohtë. • Të përshkruajë shembuj të lëvizjeve lëkundëse • nga lojërat dhe jeta e përditshme. • Të përdorë litarin dhe sustën për 	<p>Me punë dore për ndërtimin e veglërive që paraqiten në program.</p> <p>Me matematikë për shprehje të madhësive që ceken këtu.</p>

		<p>të pluskojnë në ujë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëngjet, avullojnë, valojnë dhe në gypa të hollë ngriten vetvetiu. 	<p>demonstrim të dy llojeve të valëve mekanike.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jep shembuj me të cilët vërtetohet se në natyrë nuk ka veprim, por vetëm bashkëveprim në mes të trupave. • Të demonstrojë me materiale të dendësive të ndryshme pluskimin dhe zhytjen e trupave në ujë. • Të tregojë dallimin e avullimit nga valimi, veçoritë e tyre dhe të njihet me dukurinë e kapilaritetit. 	
	<p>III. 2 Elektriciteti, magnetizmi dhe drita</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Njeriu përdorë disa lloje burimesh të rrymës elektrike. • Të njohim qarkun e thjeshtë elektrik. • Rryma elektrike ka zbatim të gjerë në jetën e përditshme, por paraqet rrezik të përhershëm. • Elektricitet ka edhe në atmosferë të Tokës dhe njeriu duhet të mbrohet prej dëmeve të shkarkimit të tij. • Drita përhapet nëpër vijë të drejtë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë lloje të ndryshme të burimeve të rrymës elektrike të vijuar (bateritë) dhe rrymës që prodhojmë me biçikletë (gjeneratori). • Të demonstrojë përbërësit e qarkut të thjeshtë elektrik (burimi, telat dhe llamba si shpenzues). • Të konstruktojë një qark të thjeshtë elektrik duke shfrytëzuar një bateri të rëndomtë, tela, ndërprerës dhe llambën si shpenzues. • Të tregojë zbatimin e rrymës elektrike në aparatet shtëpiake dhe rreziqet që paraqiten nga moskujdesi i shfrytëzimit të saj, sikurse janë telat e zhveshur, prizat e thyera, dhe të gjitha kontaktet e 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Pasqyrë e rrafshët është çdo sipërfaqe e rrafshët prej së cilës reflektohet drita. • Të ndërtojmë periskopin. • Rrezja e dritës do të thyhet gjatë kalimit nëpër dy mjedise të dendësive të ndryshme (p.sh., ajër - ujë), thyhet nëpër prizmë etj.. 	<p>drejtpërdrejta me rrymë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të interpretojë vetëtimën si çdo shkëndijë tjetër elektrike, si rrjedhojë e shkarkimit të elektricitetit atmosferik në Tokë dhe mënyrën e mbrojtjes së objekteve të larta prej saj. • Të gjejë shembuj nga jeta e përditshme që të vërtetojë se drita përhapet nëpër vijë të drejtë. • (krijimi i hijeve). • Të tregojë se drita reflektohet nga çdo sipërfaqe e lëmuar (qelq, ujë i qetë, apo pasqyrë) dhe të veçojë dallimet në mes të objektit dhe shëmbëllimit të tij në pasqyrë të rrafshët. • Të ndërtojë periskopin me ndihmën e kartuçit në formë të prizmit dhe dy pasqyrave të rrafshta. • Të paraqesë prova me të cilat tregon thyerjen e dritës gjatë kalimit nëpër dy mjedise të dendësive të ndryshme (luga në gotë të çajit apo monedha e zhytur në fund të enës me ujë). 	
IV. Toka dhe hapësira	IV. 1 Rrethina ime	<ul style="list-style-type: none"> • Njeriu dhe rrethina - Format e sipërfaqes tokësore-relievi, 	<p>Nxënësi do të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të vlerësojë vetitë fizike të mjedisit natyror në rrethinën dhe më gjerë. 	<ul style="list-style-type: none"> * Art figurativ, - Prezantim grafik i

		<p>shkëmbinjte, mineralet, tokat.</p> <p>- Atmosfera, ndërtimi, rrezatimi diellor, temperatura, lagështia e ajrit, shtypja e ajrit, lëvizja, reshjet, erërat, moti, klima</p> <p>- Uji , vetitë, qarkullimi i ujit, pasuritë ujore në Tokë, trupat ujqorë oqeanet, lumenjtë, liqenet, akullnajat, kënetat.</p>	<p>- Të dallojë tipat kryesorë të shkëmbinjve, minerale dhe rëndësinë e tyre.</p> <p>- Të përshkruajë se shkëmbinjte u nënshtrohen ndryshimeve të përhershme (shpërbashkimi, transporti dhe fundërimi).</p> <p>- Të vlerësojë tipat kryesorë të tokave.</p> <p>- Të shpjegojë se atmosfera përbëhet prej gazrave dhe shtojcave të ndryshme.</p> <p>- Të tregojë rëndësinë e atmosferës për proceset në natyrë dhe jetën në Tokë (rrezatimin diellor, mbrojtjen nga meteoritet, qarkullimin e ujit etj.).</p> <p>- Të përshkruajë se burim i nxehtësisë është rrezatimi diellor dhe shkaqet e shpërndarjes jo të njëjta në Tokë.</p> <p>- Të shpjegojë ç'është moti, klima dhe ndryshimet e tyre.</p> <p>- Të tregojë ku, si shënohen dhe mblidhen të dhënat për motin.</p> <p>- Të përshkruajnë se me avullimin dhe kondensimin e ujit krijohen mjegullat, retë dhe reshjet (shiu, bora, vesa etj.).</p> <p>- Të shpjegojë se ç'është trysnia e ajrit dhe pse lëviz ajri (era).</p> <p>- Të shpjegojë vetitë kryesore të ujit (ripërtëritja në natyrë, gjendja agregate, aftësia tretëse).</p>	<p>tipareve të natyrës.</p> <p>* Punë dore,</p> <p>- Krijimi i modeleve të ndryshme.</p> <p>* Edukatë qytetare,</p> <p>- Njerëzit jetojnë dhe veprojnë në hapësirë lokale, raportet e tyre. Njerëzit jetojnë në treva të ndryshme.</p> <p>* Gjuhë</p> <p>- Përdorimi standard i koncepteve</p>
--	--	---	--	--

	IV. 2. Skica, plani, harta, globi, leximi dhe përdorimi	<ul style="list-style-type: none"> • Skica, plani, harta, globi, rrjeti hartografik (paralelet dhe meridianet), leximi dhe përdorimi i planeve dhe hartave, orientimi në natyrë 	<ul style="list-style-type: none"> - Të përshkruajë qarkullimin e ujit në natyrë, shndërrimet e kthyeshme të ujit dhe burimet e energjisë. - Të përshkruajë trupat kryesorë ujorë në Tokë, vetitë e përbashkëta dhe dallmet në mes oqeanit dhe ujërave tokësore (lumenjtë, liqenet, akullnajat, kënetat,). - Të tregojë pasojat për njerëzimin që shkaktohen nga mungesa e ujit dhe cilësia e tij. - Të tregojë se pjesë të sipërfaqes dhe tërë Toka mund të paraqiten në letër, glob të zvogëluara dhe me shenja të veçanta. - Të shpjegojë shkallën e zvogëlimit dhe simbolet kryesore. - Të dallojë tipat kryesorë të hartave. - Të dallojë planin, hartën e trevës (vendbanimit) dhe fotografinë ajrore. - Të shpjegojë globin dhe tipat e tyre. - Të shpjegojë rrjetin hartografik, paralelet, meridianet, ekuatorin, rrethet tropike. - Të shpjegojë gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike. - Të tregojë pozitën e Kosovës në hartë dhe fqinjët e saj. 	
	IV. 3. Toka,	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi diellor, Dielli- 	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë trupat qiellorë në Sistemin 	

	<p>sistemi diellor dhe Gjithësia</p>	<p>burim i energjisë, dritës dhe jetës në Tokë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trupat e sistemit diellor, origjina e Tokës dhe sistemit diellor, pse njeriu hulumton Gjithësinë. • Toka dhe lëvizjet e saj, • ndërrimi i stinëve të vitit dhe rrjedhojat, Hëna-përcjellëse e Tokës • Përbërja e brendshme e Tokës- korja, manteli dhe bërthama (kontinentet dhe oqeanet), shkëmbinjtë, pasuritë energjetike dhe minerale të korës tokësore. 	<p>Diellor (Dielli,Toka, Hëna dhe planetët e tjerë).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë se Dielli është trup qendror i Sistemit Diellor dhe burim i dritës, nxehtësisë dhe jetës në Tokë. - Të tregojë pse njeriu hulumton trupat e Sistemit Diellor dhe Gjithësinë. - Të shpjegojë lëvizjet që bënë Toka dhe rrjedhoja që kanë rrotullimi i Tokës rreth boshtit dhe lëvizja rreth Diellit. - Të tregojë ç'është dita dhe viti dhe të vështrojë e përshkruajë ndryshimet e pozitës së Diellit gjatë ditës dhe vitit. - Të shpjegojë ndikimet e ndërrimeve të ditë-natës, stinëve të vitit dhe motit në jetën dhe në punën e njeriut, botën shtazore dhe bimore në rrethinën e tij dhe më gjerë. - Të dallojë bërthamën, mantelin dhe korën e Tokës. - Të shpjegojë se korja e Tokës përbëhet prej shkëmbinjve të ndryshëm. - Të shpjegojë se në shkëmbinj gjenden minerale dhe fosile të ndryshëm. 	
--	---	--	---	--

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe të programit të lëndës Njeriu dhe Natyra është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike siç janë: vizatime, peizazhe, diagrame, modele, grafikë, kimikate, enë kuzhine, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore – kompjuter, internet etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxësin dinamikën e orës mësimore, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathësive, qëndrimeve dhe vlerave të tjera, participojnë në tërësinë e formimit të personalitetit për t'u përballur me sfidat jetësore.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegimi, sqarimi, ushtrimet praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënës në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënës përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

- Vetë hulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitave në objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritshme.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të matur punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi, stafi arsimor, shkolla dhe komuniteti i saj. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve, përfshin këto forma vlerësimi:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo temë mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve (përgjigjet me gojë, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testimeve dhe punimeve me shkrim etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta vlerësimi dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimit i shërbejnë mësimit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësues;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktuale;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojë për përmirësimin e mësimit mbështetur në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimit dhe mësuesit e planit dhe e programit të kimit, mësimit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi:

- 1) Literaturë për lëndën Njeriu dhe Natyra në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja botërore.
- 2) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 3) Fotografji, atlasë, modele, skema, diagrame, makete, harta, glob etj.
- 4) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 5) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 6) Literaturë tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjete të tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimit që, në vartësi nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësuese, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimit dhe të mësimit.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësuese duhet t'i takojë edhe nxënësit.

EDUKATË QYTETARE

(2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Përmbajtjet programore që do të zhvillohen në klasën e pestë nga lënda edukatë qytetare janë në të vërtetë vazhdimësi dhe thellim i përmbajtjeve programore që janë zhvilluar nga edukata qytetare nga klasa e parë deri në klasën e tretë si lëndë zgjedhore dhe nga klasa e tretë si lëndë e rregullt mësimore.

Kështu nga kategoria **Grupet dhe Institucionet**, në klasën e parë dhe të tretë është mësuar për familjen dhe shkollën , ndërsa në klasën e pestë nga kjo kategori do të zgjerohen njohuritë dhe do të mësohet për **klubet, shoqatat dhe institucionet** si forma më të larta të organizimit shoqëror.

Nxënësit do të informohen lidhur me organizimin e klubeve, shoqatave, organizatave joqeveritare si dhe institucioneve.

Në kategorinë **Qeverisja dhe Qytetaria** përqendrimi do të bëhet kryesisht në nënkategorinë që i kushtohet **edukimit medial**. Nxënësit do të njihen me forma të ndryshme të edukimit medial si dhe rëndësinë e mediave për demokratizimin e shoqërisë.

Ndërsa, nga kategoria **Ekonomia dhe Teknologjia**, nxënësit do të mësojnë për rëndësinë e shkencës dhe të teknologjisë në zhvillimin dhe në përparimin e shoqërisë.

Kategoria **Kultura** në klasën e pestë përfaqësohet me nënkategorinë **komunikimi ndërkulturor**. Rëndësia e komunikimit ndërkulturor në shoqërinë bashkëkohore është e shumëfishtë, veçmas për edukimin e fëmijëve në një shoqëri në tranzicion siç është Kosova sot.

Përmbajtjet programore që do të zhvillohen në këtë program do të jenë në harmoni me mundësitë dhe kapacitetet intelektuale të nxënësve të kësaj moshe.

QËLLIMET

Nxënësi:

- Të inkuadrohet në aktivitete të klubeve dhe të shoqatave në shkollë dhe në komunitet;
- T'i kuptojë procedurat dhe rëndësinë e zbatimit të tyre. Ai duhet të kuptojë se përmes procedurave funksionon klubi dhe institucioni qoftë ai qeveritar ose joqeveritar.
- Të përdorë gjuhën letrare, të komunikojë në mënyrë të drejtë dhe korrekte me të tjerët dhe të ushtrojë forma të ndryshme komunikimi, të shprehjes dhe të bartjes së mesazhit;
- Të aftësohet që në mënyrë të lehtë dhe pa paragjykime të komunikojnë me bashkëmoshatarët, por edhe me të rriturit që u përkasin kulturave ose komuniteteve të tjera që jetojnë në Kosovë.
- T'i mundësohet që aftësitë dhe njohuritë për teknologjinë t'i zbatojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në klasë (apo shtëpi) duke punuar në kompjuterë, por duke e përdorur internetin në komunikim me të tjerët etj.
- T'i kuptojë ndryshimet që ndodhin në natyrë dhe në shoqëri si procese të natyrshme kohore.

OBJEKTIVAT

Nxënësi:

Të njohë:

- format e ndryshme të organizimit jashtëmësimor si organizimi në klube të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës, shoqatave dhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare etj);
- procedurën e formimit dhe udhëheqjes në klub apo në shoqatë.
- mjetet kryesore të informacionit publik, si mjetet e shkruara dhe ato elektronike;

- dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme dhe nevojën e komunikimit ndërkulturor;
- disa nga rrjedhat themelore të ndryshimeve në natyrë dhe në shoqëri.

Të kuptojë:

- rëndësinë e klubeve, shoqatave dhe të institucioneve për zhvillimin e shoqërisë;
- detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga puna në klub, në shoqatë dhe në institucione;
- rëndësinë e librit, gazetave dhe revistave si burim i parë i mirëfilltë për informim;
- rëndësinë dhe format e kuptimit dhe komunikimit ndërkulturor;
- rolin e shkencës dhe teknologjisë për zhvillimin e shoqërisë;
- rëndësinë e ndryshimeve në natyrë dhe në shoqëri.

Të analizojë:

- rolin dhe cilësitë e udhëheqësit të grupit;
- rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në qeverisje dhe mënyrat e ndikimit në qeverisje.
- probleme sociale të thjeshta që trajtohen në emisionet, përkatësisht shtypin për fëmijë.
- ndikimet e teknologjisë në mjedisin jetësor;
- ndikimet e shkencës dhe teknologjisë në sjelljet e fëmijëve në shkollë, në komunitet dhe më gjerë;
- shembuj të bashkëpunimeve, ndërvarësisë ose konflikteve ndërmjet individëve, grupeve dhe komuniteteve të ndryshme kulturore që jetojnë në Kosovë;
- pse ndryshon gjithçka në natyrë dhe shoqëri.

Të vlerësojë:

- kushtet për themelimin e klubeve dhe shoqatave në shkollë dhe në komunitet;
- bashkëpunimin me klube, me shoqata dhe me institucione të tjera në shkollë dhe në komunitet;
- efektet që kanë mediat si të shkruara, ashtu dhe elektronike në zhvillimin dhe në demokratizimin e shoqërisë;
- ndikimin e shkencës dhe të teknologjisë në jetën e përditshme të njerëzve;
- rëndësinë e tolerancës ndaj kulturave të tjera dhe komunikimit ndërkulturor;
- pse mund të ndodhin ndryshimet në natyrë dhe në shoqëri.

Të zbatojë:

- rregullat dhe procedurat e klubeve, shoqatave dhe institucioneve;
- aftësi dhe shkathhtësi në përdorimin e skedave të bibliotekës së shkollës;
- njohuritë e fituara nga shkenca dhe teknologjia me rastin e komunikimit, informimit;
- reflektojë kulturë të lartë të komunikimit ndërkulturor në jetën e përditshme;
- përkujdesje ndaj mjedisit natyror dhe shoqëror.

Qëndrime dhe vlera:

- të ketë qëndrimin e tij në lidhje me punën e klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve;
- të angazhohet në nxjerrjen e gazetës së shkollës;
- të jetë i hapur e tolerant dhe të kundërshtojë çdo formë diskriminimi gjinor, etnik, fetar, racor;
- të kontribuojë në ndryshimet pozitive që ndodhin në natyrë dhe në shoqëri;
- të mbajë qëndrim kritik ndaj fjalës publike.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

STRUKTURA E PROGRAMIT

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve
GRUPET DHE INSTITUCIONET	Klubet, shoqatat, institucionet	25
QEVERISJA DHE QYTETARIA	Edukimi medial	9
EKONOMIA DHE TEKNOLOGJIA	Shkenca, teknologjia dhe shoqëria	20
KULTURA	Komunikimi ndërkulturor	15
KOHA DHE NDRYSHIMET	Ndryshimet në natyrë dhe në shoqëri	5
		74

❖ GRUPET DHE INSTITUCIONET

✓ Klubet, shoqatat dhe institucionet (25 orë)

Nxënësit duhet të përvetësojnë përmbajtjet themelore për grupet ku bën pjesë, klubet, familjen, bashkëmoshtarët, shkollën, komunitetin, marrëdhëniet në grup (si formohen klubet dhe shoqatat), pakicën dhe shumicën, këshillin e shkollës, ndihma njeri tjetrit, një vështrim për Kosovën, komunitetet fqinj, kontinetet tjera, njerëzit që kanë bërë histori, Komunitetin Evropian, solidaritetin njerëzor etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi

- kupton rolin dhe funksionin e klubit, të shoqatës dhe të institucionit;
- përshkruan detyrat e anëtarëve të klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve;
- përshkruan procedurat dhe rregullat e formimit dhe funksionimit të klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve;

- njeh dhe respekton detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të klubit, të shoqatës dhe të institucionit;
- identifikon klubet dhe shoqatat që veprojnë në komunitetin në të cilin jeton;
- vlerëson rolin e ndihmës reciproke të anëtarëve të klubeve, të shoqatave dhe të institucioneve.

❖ QEVERISJA DHE QYTETARIA

✓ Edukimi medial (9 orë)

Nxënësit të përvetësojnë konceptet themelore për mediat e shkruara dhe ato elektronike; funksionin dhe rolin e tyre në informimin dhe në demokratizimin e shoqërisë; qeverisjen dhe mediat, lirinë e mediave, librit si burim parësor i informacionit; shfrytëzimin dhe seleksionimin e informatave nga mjetet e informacionit publik etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi

- kupton rolin e rregullave dhe procedurave për funksionimin e mjeteve të informimit;
- kupton rëndësinë e mediave për zgjedhje dhe qeverisje demokratike;
- analizon rolin e mediave për qeverisje të mirë;
- përshkruan (me shembuj konkretë) mënyrat e marrjes së informacioneve për ngjarjet e ndryshme në komunitet, në Kosovë dhe më gjerë;
- vlerëson gazetën e murit të klasës dhe të shkollës.

❖ EKONOMIA DHE TEKNOLOGJIA

✓ Shkenca, teknologjia dhe shoqëria (20 orë)

Nxënësi të përvetësojë përmbajtje si: njeriu ndryshon jetën e tij; planeti i ynë në hapësirë, tokën, shkencën, zbulimet dhe shpikjet, zhvilli-

min e mjeteve të punës dhe teknologjinë e prodhimit, prodhimin dje dhe sot, profesionet e vjetra dhe të reja, ekonominë globale, qendrat tregtare, teknologjinë, kompjuterin, robotet, kujdesin për mjedisin etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi

- kupton se si njeriu e ndryshon jetën e vet;
- përshkruan zhvillimin e mjeteve të punës dhe të teknologjisë së prodhimit;
- analizon prodhimin dje dhe sot;
- identifikon dhe dallon profesionet e reja nga profesionet e vjetra
- vlerëson rolin e kompjuterit në jetën e përditshme;
- kujdeset për mjedisin në të cilin jeton.

❖ KULTURA

✓ Komunikimi ndërkulturor (15 orë)

Nxënësi të mësojë për njerëzit dhe kulturën; librin; gazetën; pikturën; fotografitë; televizionin; kinemanë dhe teatrin; sportin dhe lojërat; muzetë dhe galeritë; vendet historike, monumentet dhe amforat, legjendat, festat dhe festivalet etj.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi

- kupton rolin e librit;
- identifikon gazetatat e përditshme që dalin në Kosovë;
- dallon opinionin nga e vërteta;
- përshkruan rolin e televizionit si mjet të komunikimit ndërkulturore;
- vlerëson sportin dhe lojërat si formë e të shprehurit dhe komunikimit kulturor;

- kupton rëndësinë shoqërore të muzeut dhe të galerisë.
- dallon festat dhe festivalet më të rëndësishme të vendit

❖ KOHA DHE NDRYSHIMET

✓ Ndryshimet në natyrë dhe në shoqëri (5 orë)

Nxënësi duhet të mësojë: pse ndryshon gjithçka; për shoqërinë dikur dhe sot; për ndryshimet në natyrë.

Rezultatet e pritshme

Nxënësi

- kupton pse ndryshon gjithçka;
- analizon zhvillimet shoqërore në komunitetit;
- dallon ndryshimet që bëhen në natyrë.

QASJA LËNDORE DHE NDËRLËNDORE

Edukata qytetare e klasës pestë ka lidhje me të gjitha lëndët e tjera që mësohen në klasën e pestë:

Gjuhë shqipe: Kultura e të dëgjuarit dhe të folurit, kultura e të lexuarit dhe kultura e të shkruarit në grupet, shoqatat dhe institucionet e formuara në komunitet janë premisa kryesore në mbarëvajtjen e punës së suksesshme në to.

Matematikë: Përpunimi i të dhënave dhe publikimi i tyre çka është punë e shpeshtë e shoqatave dhe klubeve të ndryshme.

Njeriu dhe natyra: Kategoritë Toka dhe Gjithësia; Qeniet e gjalla dhe proceset jetësore janë kategori që kanë ndërlidhje të madhe lëndore me shumë përmbajtje të programit të edukatës qytetare të klasës së pestë.

Histori: Kategoria: Kosova pas Luftës së Dytë Botërore 1945-1999, Nënkatëgoria: arsimi, kultura dhe shkenca dhe sot....

Gjuhë angleze: Shfrytëzimi i informacioneve nga mediat elektronike në gjuhën angleze

Punë dore: I ka disa kategori dhe nënkategori me të cilët ndërlidhen përmbajtjet programore të edukatës qytetare, por ndër to duhet veçuar:

katëgorinë: Teknologjia e informimit dhe e komunikimit. Informimi dhe komunikimi janë si nënkategori edhe të Edukatës qytetare të klasës së pestë.

Edukatë arti figurativ: kategoritë: Të vërejturit dhe njohuritë; Të shprehurit dhe kreativiteti.

Edukatë muzikore: Formimi i grupeve muzikore në shkollë dhe në komunitet është një ndër përparësitë kryesore të edukatës muzikore. Përmbajtjet programore edhe edukimi qytetar në përgjithësi nxënësit i mundësojnë që të jenë aktivë në menaxhimin dhe udhëheqjen e këtyre grupeve dhe shoqatave.

Edukatë fizike: kategoria: Aktivitetet sportive, nënkategoria shëtitje dhe krosi; dimërimi dhe verimi. Nxënësit njohuritë e fituara nga Edukata qytetare mund t'i zbatojnë në aktivitetet e ndryshme sportive, p.sh. zgjedhja e kryesisë së një klubi, anëtarësimi në të, zgjedhja e kryetarit dhe aktivizimi dhe kontributi i tij në arritjen e sukseseve në fushën e sportit.

Edukatë figurative: kategoritë: Të vërejturit dhe njohuritë; Të shprehurit dhe kreativiteti kanë lidhje të mëdha me përmbajtjet programore të edukatës qytetare që mësohet në klasën e pestë.

UDHEZIME METODOLOGJIKE

Me qëllim realizimi të programit mësimor në këtë lëndë mund të organizohen takime me njerëz, mund të shfrytëzohen burime të ndryshme dhe të simulohen raste për zgjidhje:

- Takime me njerëz të ndryshëm të komunitetit (vëzhgime, intervista, anketime, bashkëbisedime, konsulta me ekspertë etj.),
- Përdorimi i publikimeve të ndryshme (gazeta, buletine informacioni, tekste, videokaseta, dramatizime, posterë etj.),
- Simulime (lojërat me role, simulimi i diskutimeve ose i situatave nga fusha të ndryshme të veprimtarive publike etj.).

Përveç metodave tradicionale, në lëndën e Edukatës qytetare në shumë raste mund të zbatohet **loja me role**. Për zbatimin e kësaj forme të punës është e domosdoshme të bëhet **simulimi** i një ngjarjeje. Nxënësit marrin role, p.sh., të mësuesit, drejtorit të shkollës, prindërve, policit të qarkullimit rrugor, anëtarëve të ndryshëm të komunitetit, etj. Mësuesi në këtë rast luan rolin e koordinatorit, ndërsa të gjithë nxënësit e klasës marrin pjesë aktive në këtë proces. Ata mund të ndahen sërish në grupe p.sh., grupi i punëtorëve që mbrojnë natyrën dhe parqet, grupi i fëmijëve që nuk respektojnë rregullat e caktuara për mjediset publike, etj. Gjatë një ore mësimi mund të debatohet rreth asaj se si është çështja, cilat janë rrugëzgjdhjet e problemit për të cilin debatohet, etj.

Theks i veçantë në metodologjinë e punës duhet t'u kushtohet metodave aktive të punës, si: Puna me projekte, mësimi problemor, mësimi me bashkëpunim, biseda, vëzhgime, puna në mjedise konkrete (me organizatat të ndryshme të komunitetit) etj.

Si forma të punës, mësimdhënësve u sugjerohet të organizojnë punën në klasë me çifte dhe grupe. Ndarja e nxënësve në çifte dhe grupe, u jep atyre mundësi për pjesëmarrje dhe bashkëpunim. Me këtë rast nxënësve të ndarë në çifte dhe grupe u jepet 5 minuta kohë për të vendosur p.sh. Cili është roli i udhëheqësit në klub, shoqatë apo në institucione? Kjo mund të arrihet përpara se të nisë diskutimi i gjithë klasës. Nxënësve duhet t'u tregohet koha për të cilën do të zgjidhet problemi. Ata ndahen në grupe apo çifte, ndërsa mësuesi luan rolin e mbikëqyrësit, dhe sipas nevojës edhe jep udhëzime apo sqarime. Në përfundim të orës mësimore, çiftet apo grupet raportojnë para gjithë nxënësve të klasës. Secili grup duhet ta këtë përfaqësuesin i cili raporton para klasës.

VLERËSIMI

Vlerësimi është çështje e rëndësishme e punës mësimore në shkollë si për nxënës, arsimtarë, prindër dhe institucionet që merren me çështje arsimore.

Siç keni vërejtur më lart në udhëzimet metodologjike, shumica e njësive mësimore të edukatës qytetare në klasën e pestë do të realizohen nëpërmjet punëtorive interaktive, prandaj vlerësimi i rregullt i punëtorive nga arsimtarët e posaçërisht nga nxënësit është i një rëndësie të veçantë. Ekzitojnë metoda dhe teknika të ndryshme për vlerësim, por në këtë rast do të prezantohen dy nga variantet e vlerësimit më të thjeshtë nga ana e nxënësve.

Kjo formë vlerësimi parasheh që nxënësit të vlerësojnë punëtoritë përmes tri llojeve të përgjigjeve:

- a) më ka pëlqyer shumë,
- b) mesatarisht më ka pëlqyer,
- c) aspak nuk më ka pëlqyer.

Për këtë vlerësim udhëheqësi përgatit nga tre bexha të kartonit për çdo fëmijë, të cilët në njërin anë kanë të shkruar emrin e fëmijës, ndërsa në anën tjetër pamje skematike të shprehjes së fytyrës së fëmijës:

1. i buzëqeshur,
2. indiferent,
3. i mërrrolur.

Në fund të punëtorisë (apo një ore mësimore) nxënësve u ndahen bexhat. Ata duhet të zgjedhin bexhin i cili shpreh përjetimin e tij lidhur me punëtorinë dhe ta hedhin në kuvertë. Udhëheqësi i evidencon vlerësimet e nxënësve dhe në punëtorinë vijuese ua kthen prapë bexhat atyre, në mënyrë që të mund t'i shfrytëzojnë për vlerësimin e punëtorisë së re.

Variant tjetër është që nxënësit të kenë vetëm një karton me emrin e tyre dhe të përgatiten tri kuverta me shenjë të kategorisë (me fytyra si ilustrime të kategorisë). Atëherë nxënësit e vendosin bexhin e tyre në zarf, i cili u përgjigjet përjetimeve të tyre lidhur me orën mësimore.

Në bazë të këtij vlerësimi të nxënësve, udhëheqësi (mësuesi) fiton dy lloje informacionesh:

1. Si është pranuar punëtorja (vlerësimi i nxënësve me notë si: 1, 2, 3, 4, 5)
2. Reaksionet individuale (çka i ka pëlqyer secilit nxënës, apo çka nuk i ka pëlqyer).

Kjo formë vlerësimi siguron informacione të mira dhe të besueshme për mësuesin për të identifikuar problemet e nxënësve në nxënie, si në aspektin e qasjes metodologjike, ashtu edhe në aspektin e përmbajtjes së mësimave dhe për t'i ndihmuar ata në tejkalimin e tyre.

Vlerësimi i punës së nxënësve nga ana e arsimtarit.

Arsimtari, gjatë punës së tij me nxënës, rëndësi të veçantë duhet t'i kushtojë vlerësimin të arritjeve të tyre në mësim. Vlerësimi më valid bëhet përmes testeve, në vartësi çka dëshirojmë të masim-vlerësojmë, përmbajtjen (testet e standardit të përmbajtjes) apo arritshmërinë (testet e standardit të arritjes).

Kjo nuk nënkupton eliminimin edhe të formave të tjera të vlerësimin si vlerësimin e bazuar në normë, vlerësimin periodik, vlerësimin e përhershëm (sistematik) përmes vëzhgimit në çdo orë mësimore, vlerësimin e detyrave të shtëpisë, vlerësimin përmes testeve të hartuara nga vet mësuesi etj.

Lidhur me këtë, kjo lëndë kërkon që arsimtari të jetë i përgatitur të përkrahë nxënësit në rastet kur hasin në vështirësi të përgjigjen apo dëgjojnë dhe të jenë të hapur, të dëgjojnë edhe atë që nuk është në harmoni me vlerat e tij pa kritikuar dhe vlerësuar si dhe pa i përzier gjykimet personale, diagnozat, analizat dhe këshillimet.

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e edukatës qytetare duhet të jetë i përhershëm. Ky vlerësim ka qëllime të shumëfishta. Kështu përmes vlerësimin:

- sigurohen informacione për përparimin e nxënësit;
- nxënësit aftësohen të krahasojnë arritjet e tyre me rezultatet e pritshme. Në këtë mënyrë nxënësi do të bëjë edhe vetëvlerësimin e asaj që ka arritur të zotërojë;
- sigurohet motivimi i nxënësve për punë të mëtejshme;
- sigurohet edhe realizimi i objektivave.

Kriteret për vlerësimin e nxënësve janë përcaktuar qartë në Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve.

BURIMET DHE LITERATURA

1. Erlehta Mato & Robert Gjedia & Marjana Sinani & Astriot Dautaj, Standardet e arritjes së lëndës së edukatës qytetare, Tiranë, 2003
2. Instituti i Studimeve Pedagogjike, Kurrikulat dhe shkolla, Tiranë, 2002
3. Bonnie Miller, Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit, Doracak për arsimtarë, QPEA, 2003
4. Erlehta Mato & Pranvera Kamani, Në kërkim të njohjes, Tiranë, 2001
5. Patrice Meyer – Bisch, Kultura e demokracisë sfidë për shkollat, Tiranë, 1997
6. Jerome Bruner, Kultura e edukimit, Tiranë, 2003
7. Grup autorësh, Edukata qytetare (tekste të Shtëpive botuese “Libri Shkollor” dhe “Dukagjini”) 3, 6, 7, 8, 9, Prishtinë, 2003-2005
8. Bardhyl Musai, Metodologji e Mësimdhënies, Tiranë, 2003
9. Përmbledhje punimesh, Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR, KEC, Prishtinë, 2003
10. www.dadalos.org

HISTORI

(2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Me lëndën e historisë në klasën V synohet të bëhet njohja dhe përgatitja e nxënësve për të kuptuar të kaluarën e popullit tonë nga lashtësia deri më sot.

Përmes lëndës së historisë pretendohet të krijohen mundësi për zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të nxënësve nga aspekti human, ekonomik, shoqëror, kulturor, politik etj.

Lënda e historisë në klasën V synon që nxënësit të mësojnë për të kaluarën e vendlindjes dhe të atdheut të vet, të zhvillojë atdhedashurinë për vendlindjen dhe popullin e vet si dhe krenarinë për të kaluarën e lavdishme të popullit tonë. Gjithnjë duke patur parasysh mundësitë, aftësitë psiko-fizike moshën dhe afinitetet e nxënësve.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së historisë ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të ditur, mësuar, njohur dhe kuptuar të kaluarën e popullit tonë deri në ditët e sotme.
- Zhvillimin e aftësive për të njohur dhe kuptuar mënyrën e jetesës, personalitetet kryesore nga e kaluara jonë dhe rolin e tyre. Besimin, qëndresën, kushtet e jetesës, të arriturat ekonomike, shkencore, kulturore etj.
- Zhvillimin e shkathtësive dhe shprehive të nevojshme për njohjen, kuptimin, përpunimin dhe zbatimin e të dhënave të ndryshme historike në kohë dhe në rrethana të caktuara.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të kuptojnë

- Ligjshmëritë e zhvillimeve historike si dhe vendin dhe rolin e popullit tonë në këto procese që nga lashtësia deri në ditët e sotme. Kuptimin e termave dhe shprehjeve më themelore historike.

Të kuptojnë

- Veçoritë kryesore të zhvillimeve historike në trojet shqiptare në të kaluarën.
- Konceptet më themelore të shprehjeve dhe të historisë si dhe parimet e zhvillimeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, arsimore, shkencore, religjioze, etj.,

Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera

- Të vlerësojnë dhe të çmojnë të arriturat e shoqërisë njerëzore gjatë këtyre periudhave;
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri;
- Për ruajtjen dhe kujdesin, për trashëgiminë arkeologjike, kujdesin ndaj monumenteve kulturohistorike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj.

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Nërlidhjet programore
HISTORIA E LASHTË	Iliria	<i>Nxënësit duhet të mësojnë për:</i> Lëndën e historisë, historinë e vendlindjes, historinë e të parëve të tyre, organizimin shoqëror e shtetëror, qytetet, kulturën mënyrën e jetesës etj. (9 orë)	<i>Nxënësit duhet:</i> Të kuptojnë fjalën histori, materien që studion historia, të kaluarën e vendlindjes së vet. Të njohin organizimin shoqëror dhe shtetëror të ilirëve, zhvillimin e qyteteve, kulturën, mënyrën e jetës së përditshme etj.	<i>Me:</i> Gjeografinë, edukatën qytetare, muzikën etj.
HISTORIA E MESJETËS	Arbëria	Arbërit, për jetën e tyre të përditshme, organizimin shoqëror dhe shtetëror, kulturën, qytetet, depërtimin e osmanëve, qëndresën kundër tyre etj. (7 orë)	Të njohin shtrirjen territoriale të Arbërisë dhe organizimin shoqëror e shtetëror. Të mësojnë për zhvillimin e qyteteve, qëndresën kundër osmanëve dhe mënyrën e jetës	Gjeografinë, letërsinë, artin, muzikën etj.
HISTORIA E KOHËS SË RE	Epoka e Skënderbeut dhe pashallëqet shqiptare	Familjet feudale shqiptare, Gjergj Kastriotin, Kuvendin e Lezhës, Luftërat e Skënderbeut kundër osmanëve, personalitetet e shquara të kohës, marrëdhëniet e Skënderbeut me Evropën,	Të kuptojnë dhe të informohen për gjenezën e familjeve feudale shqiptare sidomos të Kastriotëve. Të mësojnë për bashkëluftëtarët e Skënderbeut, kulturën, shpërnguljet e shqiptarëve pas	Gjeografinë, letërsinë, artin, muzikën, edukatën qytetare etj.

		zhvillimin e kulturës, pashallëqet shiptare etj. (10 orë)	vdekjes së Skënderbeut. Të njohin familjet feudale që themeluan pashallëqet e mëdha shqiptare.	
	Rilindja Kombëtare Shqiptare	Fillimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Lidhjen e Prizrenit, Lidhjen e Pejës, qytetet, popullsinë, shkollat, kulturën dhe artin, personalitetet, mënyrën e jetesës, qëndresën antiosmane, Shpalljen e Pavarësisë etj. (11 orë)	Të mësojnë për rrjedhat dhe etapat e zhvillimit të Rilindjes Kombëtare. Të kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të kulturës dhe të artit për qëndresën kundërosmane që kishte rezultat Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.	Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare etj.
HISTORIA E KOHËS MË TË RE	Shqiptarët gjatë viteve 1912-1945	Shqipërinë nën udhëheqjen e Vidit, Luftës së Parë e të Dytë Botërore dhe në kohën e Ahmet Zogut. Pushtimin dhe ripushtimin e Kosovës nga Serbia dhe Mali i Zi, pozitën dhe qëndresën e shqiptarëve në Mbretërinë e Jugosllavisë dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore etj. (8 orë)	Të kuptojnë raportet shoqërore-ekonomike dhe politike që mbizotëruan në trojet shqiptare pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Të mësojnë për qëndresën e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera kundër pushtetit të Mbretërisë SKS.	Gjeografinë, edukatën qytetare, artin, muzikën etj.

	Kosova pas Luftës së Dytë Botërore (1945-1999)	Çlirimin e Kosovës nga fashizmi dhe ripushtimin nga Jugosllavia, qëndresën, pozitën dhe kërkesat e shqiptarëve për Republikën e Kosovës. Arsimin, kulturën, shkencën etj. Shpalljen e republikës, referendumin, zgjedhjet parlamentare e presidenciale si dhe çlirimin e Kosovës më 1999 (8 orë)	Të kuptojnë gjendjen e rëndë të shqiptarëve nën pushtetin e Jugosllavisë. Të njohin kërkesat dhe qëndresën e shqiptarëve kundër vendosjes së pushtetit jugosllav. Të mësojnë për të arriturat në arsim, shkencë, kulturë etj. Të çmojnë qëndresën politike dhe të armatosur dhe rezultatet e saj.	Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë, artin, muzikën etj.
--	---	---	--	--

Vërejtje: 4 orë mësimore mbeten në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Lënda e historisë mund të mësohet dhe të interpretohet përmes metodave dhe teknikave të ndryshme. Metodologjia e re e mësimdhënies dhe nxënies e bën nxënësin më të aftë për të vështruar, për të gjykuar drejt ngjarje të rëndësishme historike, pavarësisht në çfarë forme i paraqiten ato.

Mësimdhënësi bën zgjedhjen e metodave dhe teknikave mësimore duke ua përshtatur aftësive dhe kërkesave të nxënësve. Ai duhet të jetë i kujdesshëm për shkallën e arritshmërisë së objektivave gjatë procesit mësimor.

Që të jetë sa më i suksesshëm në mësimet e historisë duhet përdorur metoda dhe teknika sa më të shumëllojshme me qëllim të nxitë dinamizimin e orës, të motivojë nxënësit për punë, duke pasur parasysh se nxënësit kanë nivele të ndryshme aftësish dhe njohurivsh.

Për të pasur mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme duhet përdorur disa nga këto metoda dhe teknika:

- Puna me gjithë klasën
- Puna në grupe
- Puna në çifte
- Puna individuale
- Metodatat e vëzhgimit, diskutimit, demonstrimit, interpretimit,
- Vërshimi i shpejtë i ideve (Breinstorming)
- Puna kërkimore, hulumtuese, praktike, krahasuese
- Loja me role
- Të mësuarit problemor
- Kllasteri (teknikë e mendimit kritik-grumbulli apo pema e mendimeve)
- Pesëvargëshi,
- Xhigsou,
- Historia gojore etj.
- Vizita në: muze, kinema, ekspozita, institucione kulturo - historike etj.

Përdorimi i suksesshëm i të gjitha këtyre metodave dhe teknikave mundësojnë mësimdhënien me nxënësin në qendër dhe zhvillimin e mendimit kritik.

Përdorimi i metodave dhe teknikave nuk garanton sukses nëse mësimdhënësi nuk planifikon me kujdes përmbajtjen mësimore, caktimin e objektivave, përshtatjen e teknikave për realizimin e objektivave dhe nëse nuk vëzhgon si mendojnë dhe punojnë nxënësit për përpunimin e informacionit.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit të vazhdueshëm i dokumentimit të punës së nxënësve dhe ka të bëjë me çdo lloj veprimtarie dhe matje që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve.

Në mënyrë që të sigurojmë informacione të mjaftueshme për të vlerësuar arritjet e nxënësve në lëndën e historisë, duhet të përdoren mjete dhe teknika të ndryshme.

Disa qëllime të vlerësimit:

- Të identifikojë përparimin e nxënësve dhe t'u ofrojë të dhëna të mjaftueshme.
- Të motivojë nxënësit për punë
- Të sigurojë informacione për shkallën e arritshmërisë së objektivave
- Të ndihmojë nxënësin dhe mësimdhënësin
- Të përmirësojë nxënien dhe mësimdhënien
- Të sigurojë informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm etj.

Rëndësia e këtyre qëllimeve është:

- Përmes vlerësimit mësimdhënësi siguron informacione sa e suksesshme ka qenë mësimdhënia e tij për të arritur rezultatet e caktuara dhe në bazë të arriturve të tyre mësimdhënësi t'u ofrojë sqarime nxënësve dhe të planifikon përmbajtjen mësimore sipas nevojave të nxënësve në të ardhmen.

Vlerësimi është i rëndësishëm për të kuptuar sa janë në gjendje nxënësit të punojnë një përmbajtje mësimore me qëllim të organizojmë më mirë punën në grupe dhe për të vërtetuar në çfarë mase i kanë përvetësuar nxënësit njësitë e mësuara. Në bazë të këtyre të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë dhe të bëjnë përforsimin e atyre njësive.

Tipat e vlerësimit

- **Vlerësimi formues** ka për qëllim të udhëzojë mësuesin në planifikim dhe të nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.
- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies p.sh., pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.
- **Vlerësimi në bazë të kriterëve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara p.sh., krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë në përmirësimin e tyre.
- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton të nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.
- Vlerësimi **formues** dhe **diagnostikues** nuk vlerëson me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikonë punën e tij.
- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** mbështetet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe mbështetet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi** në proces mbështetet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune apo detyre në zhvillim.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- *Kontrolli i rëndomtë i veprimtarive në klasë*
- *Detyrat e shtëpisë*
- *Testet*

- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.
- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojmë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë, në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherësh mund të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

Format e testeve janë:

- ❖ Me gojë
- ❖ Me shkrim
- ❖ Përmes paraqitjes grafike etj.

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anët negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj.

- ❖ Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari të tjera, p.sh.,
 - Vlerësimi i eseve
 - Vlerësimi me dosje
 - Vetëvlerësimi...etj.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Prishtinë, 1997
2. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Tiranë, 1995
3. Bardhyl Musai, Psikologjia e Edukimit, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë, 1999
4. Bardhyl Musai, Metodologjia e Mësimdhënies, Tiranë 2003
5. Vilson Kuri, Ragip Zekolli, Bep Jubani, HISTORIA 5, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 1999

6. Grup autorësh, Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, nën redaktimin e prof. Dr. Hysni Myzyrit, Botoi: Siptinti, Prizren 2000
7. Grup autorësh, Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët par të ndërtuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000, Botues: EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë 2003
8. Mikel Pjetrush, Atlas historik i botës, Shtëpia Botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001
9. Kristina Popova, Petar Vodenicharov, SnezhanaDimitrova, Gratë dhe burrat në të kaluarën (shekulli XIX dhe XX) *Materiale mësimore plotësuese për shkollat 8-vjeçare*.Blagoevgrad, 2002.

BURIMET NË INTERNET

1. www.dadalos.org
2. www.eurocliohistory.org
3. www.euroclio.net
4. www.bbc.co.uk/history

EDUKATË MUZIKORE

(1 orë në javë, 37 orë në vit)

HYRJE

Muzika është pjesë e formimit kulturor dhe nevojë e përhershme e njeriut.

Ajo komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kreative me tërë qenien e tij duke ia formuar mjedisin tingëllor. Nisur nga roli i muzikës në jetën e njeriut dhe ndikimit që ka në të, del dhe rëndësia e formimit edukativ-muzikor.

Edukata muzikore mundëson:

- dëgjim selektiv dhe aktiv të muzikës në programet e mediave dhe shfaqjeve muzikore;
- pjesëmarrje në formacione korale - instrumentale dhe në veprimtari të tjera muzikore;
- arsimim të mëtijshëm i cili nxit interesim më të gjerë për muzikën, në të vërtetë përgatitjen për ndonjë profesion ku muzika është pjesë përbërëse.

QËLLIMET

Lënda ka për qëllim:

- Të sjellë gëzim, emocione dhe të zgjojë interes për veprimtari të ndryshme muzikore;
- Të zhvillojë dhe të ngre muzikalitetin në vazhdimësi;
- të ndikojë në formimin e qëndrimit pozitiv ndaj muzikës kombëtare dhe botërore;

- të edukojë për mjedis të shëndoshë tingëllor;
- të zhvillojë kriteret për vlerësim dhe mendim kritik;

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit do të:

- **muzikojnë në mënyrë të përbashkët dhe individuale:**
 - këndojnë këngë popullore dhe artistike shqiptare dhe të popujve të tjerë, sipas imitimit (veshit) dhe notacionit (solmizimit), pa dhe me shoqërim instrumental;
 - luajnë në vegla muzikore ritmike dhe melodike (popullore dhe te ORF-it), sipas imitimit dhe notacionit;
 - njohin në mënyrë të vetëdijshme dukuri të ndryshme ritmike (masat e përziera) dhe melodike (shkalla muzikore) të cilat i kanë përjetuar në klasat paraprake(1-4);
 - zhvillojnë kulturën vokale (qëndrimi, frymëmarrja, artikulimi, këndimi i bukur dhe shprehjeplotë, gradacionet në temp dhe në dinamikë)
- **zhvillojnë aftësinë për dëgjim aktiv përjetues dhe analitik të muzikës**
 - vërejnë dhe dallojnë karakterin shprehës, instrumentet muzikore dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjua;
 - dallojnë llojet (gjinitë) dhe zhanret e ndryshme muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
 - dallojnë pjesët përbërëse dhe njohin formën e këngës dy-pjesore gjatë këndimit dhe veprimtarive të tjera muzikore;
- **zhvillojnë të shprehurit kreativ:**
 - nxiten për shprehje të përjetimeve dhe përfytyrimeve muzikore përmes lëvizjes, vallëzimit, shprehjes figurative dhe gjuhësore sipas prirjeve individuale;
 - nxiten për shprehje kreative muzikore ritmike dhe melodike.

VEPRIMTARITË MUZIKORE			
I N T E R P R E T I M	<ul style="list-style-type: none"> ▪ këndojnë këngë popullore dhe artistike një e dy zërëshe (me ostinato) e ligjërojnë ritme sipas veshit (imitimit) duke përdorur simbolet grafike dhe duke njohur notacionin muzikor ▪ Në vegla muzikore (fëmijërore, të ORF-it dhe të tjera), interpretojnë shoqërimi dhe kompozime të shkurtra instrumentale me simbole dhe shenja muzikore ▪ Kultivojnë këngën popullore ▪ Zbatojnë teknikën themelore të të kënduarit dhe luajtjes instrumentale me formësim estetik duke përdorur simbolet dhe shkrimin notar muzikor 	<p>PËRMBAJTJET TEMATIKO-INFORMATIVE</p> <p>MUZIKA NË RRETHIN TONË</p> <ul style="list-style-type: none"> • Muzika në familje dhe në shkollë • Koncerti i klasës • Si përgatitet një koncert • Çka mësojnë nxënësit në shkollë të muzikës • Muzika në shfaqje dhe në koncerte (opera, muzikë baleti, muzika për film etj) • Kënga më e bukur e gjysmëvjetorit – vitit • Shoqërimi ritmik me kombinim instrumental <p>MUZIKA - TRASHËGIMIA IME</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instrumentet tona popullore • Këngët dhe vallet tona popullore <p>NJOHIM DUKURI TË REJA MUZIKORE (RITMIKE E MELODIKE)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohim - ndarjen 4 pjesore të njësisë për numërim (16-she) shenjat e shartimit (#, b) • Masa të përziera (5/8, 7/8, 9/8) • Shkalla a-mol harmonike dhe melodike, Shkalla F-dur) 	<p>BURIMET ARTISTIKE</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kënga e Flamurit 2. Feston Republika I. Hoxha 3. Bleta dhe flutura Z. Zani 4. Hapa dollapa 5. Duar të arta ke P. Badivuku 6. Kënga e qershisë (gjëgjëzë) 7. Ku po bajm konak për mbrama (pop.) 8. Erdhi Prilli - pop.labe 9. Lan vasha - popullore 10. Ishin dy kunata (pop.) 11. Rënkimi i zogut Bethoven 12. Xixëllonja – G. Zajmi 13. Iku dimri (Zvicerane) 14. Urim i vitit të Ri 15. Hopa Hop - D. Zeqiri 16. Mace pa kulturë (V. Kotani)

<p>D Ë GJ I M</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>dëgjojnë me vëmendje kompozime të ndryshme nga muzika programore dhe absolute</i> ▪ <i>shprehin përshtypjet e tyre mbi përjetimin muzikor</i> ▪ <i>përcjellin ngjarjet kulturore në mjedisin e tyre</i> ▪ <i>Vallëzojnë</i> ▪ <i>Dallojnë dhe njohin instrumentet muzikore ne veprat qe dëgjojnë</i> ▪ <i>përjetojnë formën e këngës dypjesore- ab</i> ▪ <i>Dallojnë tempin ngadalë-shpejt dhe accelerando e rittardando</i> 	<p><i>ME MUZIKË NË BOTËN E IMAGJINATËS</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Muzikë baleti dhe filmi</i> ▪ <i>Vallëzojmë me muzikë</i> ▪ <i>Bisedojmë dhe mësojmë për krijimin e muzikës</i> <p><i>DËGJOJMË MUZIKË, MËSOJMË INSTRUMENTET MUZIKORE</i></p> <p><i>Oboa, Kontrabasi ksilofoni, metalofoni, -blokflauti, flauti</i> <i>- zilet, trekëndëshi</i> <i>- çiftelia, fyelli, defi etj.</i></p> <p>MUZIKA KA FORMË <i>- kënga, (dy pjesore e thjeshte)</i></p> <p>MUZIKA KA TEMP <i>- muzikë e ngadalshme dhe e shpejte</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>E. Rizvanolli: Skerco</i> ○ <i>L. Antoni: Çorapet e burrit(Korale)</i> ○ <i>R. Mulliqi: Akuarelet e Prizrenit</i> ○ <i>T. Harapi Album për fëmijë</i> ○ <i>M. Kaçinari: Fyelli i bariut</i> ○ <i>A. Koci Oj llokumja (Korale)</i> ○ <i>V. Gjini: Vashe me sytë e zi (Korale)</i> ○ <i>F. Ibrahim i Marche a-mol pf.</i> ○ <i>T. Daija Suitë</i> ○ <i>Hajdn Sonata për piano op.30 nr.1</i> ○ <i>H. Kasapoli- Suitë për kor</i> ○ <i>ShDeshpali: Lulëzoi lulja(korale)</i> ○ <i>B. Jashari: Nji lule- korale</i> ○ <i>F. Ibrahim i: Rapsodia shqiptare</i> ○ <i>Bethoven: Për Elizen</i> ○ <i>L. V. Bethoven: Simfonia nr.6 “Pastorale “ – koha e tretë</i>
--	---	--	---

			<ul style="list-style-type: none"> ○ M.Musorgski : Tablo nga ekspozita ○ K.Sen Sans Karnavali i shtazëve(zogjtë) ○ Shostakoviç: Quartet No.8,II.Alleg. Molto-KRONOS ○ TAKEMICU: 2 pjes ^{ソナタ} pianistike për fëmijë, (A.TAKAHASHI) ○ Çast poetik per piano R. CIKO ○ SCHUBERT Andante.,pf,vl.vlc.,
K R I J I M	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zgjedhin dhe përdorin tinguj (me zë ose instrumente) për tu shprehur ▪ Krijojnë tërësi te reja muzikore 	<p>ME MUZIKE TREGOJME NGJARJE DHE SHPREHIM PERJETIME</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Me zërin tone ose me instrumente shprehim/tregojmë/imitojmë/, ngjarje, atmosfere, karaktere(personazhe) etj. ▪ Krijojmë dhe interpretojmë ritme e melodi te reja, shoqërime për këngët tona dhe pjese për veglat tona muzikore 	
	nxënësit gjatë gjithë aktivitetit muzikor shprehin përjetimin e tyre edhe përmes lëvizjes, shprehjes figurative dhe shprehjes letrare		

UDHËZIMET DIDAKTIKO-METODIKE

Edukimi muzikor në klasën V është një vazhdimësi dhe thellim i disa komponenteve mësimore të cilat janë punuar edhe në klasët e mëparshme (1, 2, 3 dhe 4), sidomos në pikëpamje të përjetimit të dukurive të ndryshme muzikore. Në klasën e katërt vazhdon të prijë përdorimi i simboleve grafike dhe inkuadrimi gradual e i matur i vetëdijshëm i notacionit të vërtetë muzikor. Kjo realizohet duke iu përmbajtur parimit të përjetimit të dukurisë së re muzikore për të shkuar gradualisht kah njohja e vetëdijshme e tyre. Në këtë klasë vazhdohet me njohjen e vetëdijshme të shkallës muzikore si koncept, asaj F-dur dhe përforcimi i C-dur e A-mol, përpunimi i shkallës muzikore bëhet përmes këngës në atë tonalitet e pastaj pas njohjes përforcohet të kuptuarit e saj me ushtrime melodike dhe me këngë të kënduara sipas tekstit notal.

Me një planifikim të mirë, përmbajtjet programore nga veprimtaritë muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) të cilat u ofrohen nxënësve duhet të jenë në përputhshmëri me mundësitë e zhvillimit të tyre të përgjithshëm dhe atij muzikor në veçanti.

Mësimdhënia muzikore duhet të realizohet duke aplikuar shumëllojshmërinë në procesin mësimor në kuptim të kombinimit të veprimtarive bazë. Mësimdhënësi do të aplikojë metoda dhe forma aktive të punës të cilat garantojnë sukses në procesin edukativ-muzikor.

Veprimtaritë mësimore – muzikore (interpretimi, dëgjimi dhe krijimi) paraqiten të ndërlidhura dhe janë gati të pandashme, prandaj formulimi i njësive mësimore duhet të kombinohet me së paku dy veprimtari të ndryshme. Kjo duhet bërë jo vetëm për shkak të natyrës së lëndës, por edhe që t'u bëhet e mundur nxënësve veprimtari aktive në vartësi nga aftësitë individuale të tyre.

Përmbajtjet programore bazohen në:

1. Literaturën e përzgjedhur muzikore për dëgjim dhe interpretim;
2. Njohuritë, konceptet dhe ligjshmëritë muzikore të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të arsimimit muzikor;
3. Informacionet për kulturën muzikore të mjedisit të nxënësit si dhe formimin e qëndrimit estetik dhe pozitiv ndaj krijimtarisë kombëtare dhe botërore.

INTEPRETIMI

Interpretimi si një nga veprimtaritë themelore muzikore që u ofrohet nxënësve realizohet përmes këndimit dhe luajtjes në vegla muzikore bazohet në:

- Interpretimin e këngëve sipas imitimit dhe sipas teksti notal në shkallët e mësuara. Përdoret edhe metoda e kombinuar;
- Përjetimin dhe njohjen e dukurive ritmike e melodike (masat, njësia, për numërim, krahasimi i tonalitetit dur dhe mol etj.).

Në këndim zbatohet të kënduarit sipas veshit (imitimi) duke respektuar individualitetin e nxënësve dhe aplikohet përdorimi i notacionit të vërtetë muzikor. Mësimdhënësi duhet të ketë kujdes në ambitusin e nxënësve dhe të synojë vazhdimisht për këndim të drejtë dhe të bukur, duke respektuar pozitën e drejtë gjatë këndimit, frymëmarrjen e duhur, shqiptimin dhe artikulimin e saktë si dhe inkorporimin e ngjyrimin dinamik dhe të shprehjes emocionale. Në këtë klasë i kushtohet kujdes edhe ndjenjës për formë duke nxitur nxënësit të vërejnë formën e këngës kur këndojnë dhe në veprat që i dëgjojnë në kuptim të të vërejturit të tërësive të mëdha (dy pjesshmërinë).

Luajtja me veglat muzikore zbatohet në shoqërimin e këngëve ose e lidhur me lëvizjen dhe vallëzimin, por edhe në të shprehurit kreativ muzikor të nxënësve, duke i përdorur ato për riinterpretimin apo krijimin e tërësive të reja muzikore.

DËGJIMI

Dëgjimi muzikor në klasën e pestë si edhe më parë duhet realizuar duke iu përmbajtur objektivave të kësaj klase dhe duke synuar në dëgjim përjetues të shprehjes muzikore të veprës. Procedura metodike e dëgjimit duhet të realizohet me kujdes, duke pasur parasysh kohëzgjatjen përkatëse të veprës në funksion të përqendrimit të vëmendjes si dhe mundësinë për shprehje kreative në bazë të dëgjimit.

Dëgjimet duhet të jenë të shkurtra dhe të shpeshta. Dëgjimi i përsëritur i veprës i ndihmon nxënësit të vërejnë dhe të dallojnë gjithnjë mjete dhe elemente të reja nga shprehja muzikore. Gjatë dëgjimit duhet të insistohet në të vërejturit e mjeteve dhe formacioneve interpretuese, karakterin shprehës të veprës, ngjyrat e ndryshme tingëllore dhe elementet muzikore si ritmi, melodia, harmonia (në kuptim të diferencimit të

tingëllimës në dur dhe mol). Mësimdhënësi bën përzgjedhjen e veprave për dëgjim nga shembujt e propozuar në programin mësimor, duke i ndërlidhur me përmbajtjet tematike dhe veprimtaritë e tjera (interpretimin, krijimin). Përgatitjet motivuese para dhe pas dëgjimit mundësojnë dëgjim aktiv dhe të vëmendshëm.

KRIJIMI

Aktivitetet krijuese në këtë klasë kryesisht realizohen përmes lojës kreative dhe të shprehurit me mjete të tjera si lëvizja dhe vallëzimi që paraqesin aktivitetet bazë përmes të cilave nxënësit shprehin përjetimet e tyre muzikore, por inkurajohet edhe shprehja figurative dhe gjuhësore e mbështetur në inspirimin nga muzika e dëgjuar. E rëndësishme është sidomos forma e të shprehurit muzikor; bisedat muzikore (pyetjet e përgjegjet muzikore që realizohen me zë ose me vegla muzikore), improvizimet meloritmike të ndryshme dhe krijimi i tërësive të reja muzikore.

Në këtë formë posaçërisht, mësimdhënësi inkurajon nxënësit dhe i këshillon ata, por u siguron lirinë e nevojshme për këtë veprimtari muzikore. Ai shënon dhe konservon (incizon, memorizon) krijimet e tyre dhe i nxit për vlerësim kritik të punës së tyre dhe të nxënësve të tjerë duke i caktuar kriteret sa më të kuptueshme për një vlerësim të tillë.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi bën vlerësimin e arritjeve të edukimit muzikor në bazë të kërkesave profesionale didaktike dhe psikologjike. Vlerësimi bëhet në kuadër të grupit, duke vlerësuar arritjet në zhvillimin muzikor individual të nxënësve në dëgjimin aktiv, interpretimin vokal-instrumental dhe punën krijuese.

Mësimdhënësi përcjell, evidencon dhe vlerëson aftësitë muzikore shkathtësitë interpretuese, dituritë informative, ndieshmërinë dhe interesimin e nxënësve.

Vlerësohet rinjohja dhe përjetimi i shprehjes muzikore në veprat e dëgjuara.

Interpretimi vokal dhe instrumental vlerësohet në bazë të përvetësimit të numrit të caktuar të këngëve dhe përmbajtjeve instrumentale, saktësisë melodike-ritmike dhe interpretimit të përjetuar. Vlerësimi duhet të jetë i baraspeshuar mes këndimit sipas veshit, tekstit notal dhe mënyrës

së kombinuar gjithnjë duke pasur parasysh mundësitë individuale të nxënësve.

Mësimdhënësi duhet ta përcjellë dhe inkurajojë interesimin e nxënësit për shprehje kreative; në veçanti vlerësohet:

- rinjohja e veprave të dëgjuara,
- këndimi dhe luajtja instrumentale,
- diktimet melodike dhe ritmike,
- përgjigjet me gojë dhe me shkrim,
- prezantimi.

Instrumente të tjera vlerësimi janë:

- testi,
- vetëvlerësimi.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultatet e arritshmërisë në vartësi nga objektivat e parashtruar.

FORMAT E VEÇANTA TË OBLIGUESHME TË MËSIMDHËNIES MUZIKORE

Puna me kor dhe orkestër është formë e veçantë dhe e obligueshme e edukimit muzikor në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Në kor dhe në orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë interpretimi muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore edhe në nivelin e shkollës fillore (kori i ciklit të ulët - dhe ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhënësit llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor prej 2 orë). Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezanton program me kritere artistike – pedagogjike.

EDUKATË FIGURATIVE

(1 orë në javë, 37 orë në vit)

HYRJE

Plani dhe programi i **Edukatës figurative** për klasën e pestë, nxënësve të këtij niveli u ofron përvetësim të bollshëm dhe zhvillim të mjaftuar të njohurive në kuptimin e dallimit të dukurive me trajta natyrore e artistike. Zhvillimi kulturor i nxënësve përfshin aftësinë e përgjegjes së përshtatshme ndaj vlerave estetike të shoqërisë tonë dhe kërkesave të etnive të tjera të cilat shkollohen në Kosovë. Kjo lëndë gjithashtu u mundëson nxënësve zgjerimin e horizonteve të reja, sugjerimin dhe mundësinë e rrugëve inovative lidhur me të bukurën dhe vlerën estetike.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së Edukatës figurative të klasës së pestë ka për qëllim, hulumtimin, kreativitetin ideor, përfundimin logjik si dhe realizimin e vlerësimit kritik në vepra e punë kreative. Nxënësit, këtë vit shkollor, hulumtojnë dhe përdorin materiale dhe procese të ndryshme pune, duke përdorur mënyra që komunikimi me idetë dhe domethëniet e tyre të avancojë njohuritë dhe përvojat e përgjithshme mësimore në arsimin fillor.

- Nxënësit finalizojnë informatat e rritshme verbale e pamore dhe demonstrojnë aftësitë e tyre kreative. Ata tashmë përmyllin një fazë evoluese e cila do t'u shërbejë në vitet vijuese.

OBJEKTIVAT

E përgjithshëm	Specifikë
<i>Nga përmbajtja programore e klasës së pestë, nxënësi do të jetë në gjendje:</i>	
➤ Të hulumtojë	<ul style="list-style-type: none"> • Idetë dhe metodat e qasjeve të reja. • Teknikat shprehëse gjatë procesit mësimor.
➤ Të zgjerojë njohuritë	<ul style="list-style-type: none"> • Në pasurimin e gjuhës figurative dhe mësimëve të tjera teorike. • Nga puna praktike dhe përdorimi i teknikave. • Në fushat e ndryshme të artit figurativ.
➤ Të ndjejë	<ul style="list-style-type: none"> • Aftësimin e punës personale për vetëiniciativë krijuese. • Strukturat përbërëse të materialeve punuese. • Përjetimin nga punimet figurative gjatë vizitës në muze apo galeri arti.
➤ Të aplikojë	<ul style="list-style-type: none"> • Përvojat shprehëse ndaj mjeteve dhe teknikave punuese.
➤ Të analizojë	<ul style="list-style-type: none"> • Qasjet dhe idetë e propozuara rreth detyrave të shtruara. • Vlerësimin e punimeve sipas përvojave personale.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë
I. Të vërejturit dhe njohuritë	Perspektiva në hapësirë.....3 orë
	Forma dhe figuracioni.....3 orë
II. Të shprehurit dhe kreativiteti	Vijat dhe llojet e vizatimit.....7 orë
	Ngjyrat dhe llojet e teknikave.....7 orë
	Materialet dhe puna tridimensionale.....4 orë
III. Analiza dhe vlerësimi	Komponentet figurative.....3 orë
	Veçoritë e artit figurativ dhe aplikativ.....6 orë
	Përshkrimi figurativ.....2 orë
	Orë të zgjedhura2 orë

I. Të vërejturit dhe njohuritë

- **Udhëzim:** Aftësimi i nxënësve gjatë procesit të mësimit në vrojtim të perspektivës hapësinore dhe trajtave figurative, duke i përdorur ato në krijime gjatë aplikimit të teknikave figurative.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
• Perspektiva në hapësirë (3 orë)	Njohtimi dhe zgjedhja e temave nga: ❖ Perspektiva hapësinore: - Shtyllat përgjatë rrugës, - Pamjet nga lartësia. - Lagjja ime etj.	○ <i>Vizatim e ngjyrosje- 3orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i>	Nxënësit do të: • Zhvillojnë aftësinë për pamjet e perspektivës në hapësirë; • Vizatojnë dhe ngjyrosin punime nga temat e dhëna;
• Forma dhe figuracioni (3 orë)	Zgjedhja e temave nga: ❖ Figuracioni natyral e artistik: - Natyrë e qetë, - Festa e Vitit të Ri, - Modelimi i figurës së zgjedhur.	○ <i>Vizatim e ngjyrosje- 2orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra uji etj.)</i> ○ <i>Modelim-1 orë, (plastelinë, letër me ngjyra, tekstil, sapun, gurë, etj.)</i>	Nxënësit do të: • Bëjnë dallimin dhe krahasimin e formave, figurave natyrore e artificiale. • Shprehen me punime të formave me trajta të ndryshme.

II. Të shprehurit dhe kreativiteti

- **Udhëzim:** Të shprehurit dhe kreativiteti të nxënësit e kësaj moshe pasqyrohet përmes punës kreative nga motivet e zgjedhura për krijim gjatë përdorimit të mjeteve shprehëse në detyrat hulumtuese. Vazhdimi i

përvojës në vizatim, ndikimi emocional i ngjyrave dhe efekteve të tjera realizuese me forma tridimensionale janë pjesë kompakte e kësaj kategorie.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<p>• Vijat dhe llojet e vizatimit (7 orë)</p>	<p>Njohja dhe përcaktimi i temave të zgjedhura në bazë të modeleve për vizatim sipas llojeve të vizatimit: kroki, skicë, karikaturë dhe analitik si psh:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Figurë njeriu; • Peizazh; • Personazh nga filmat vizatimorë; • Portret; • Ilustrimi i përrallës • Dhoma ime; • Cirku 	<p>○ <i>Vizatim 7 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, shkopinjtë thëngjilli, tush dhe penë etj.)</i></p>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohin llojet e vijave dhe vizatimeve sipas teknikave realizuese. • Vizatojnë peizazhe, natyrën e qetë dhe portrete nga modelet e zgjedhura. • Shprehen me vija, e mjete të tjera krijuese gjatë punimeve të temave të zgjedhura.
<p>• Ngjyrat dhe llojet e teknikave (7 orë)</p>	<p>Përfitimi i nuancave me ngjyra, si dhe përshtatja e temave në bazë të teknikave punuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Peizazh vjeshte; • Kartolina e Vitit të Ri; • Natyrë e qetë me pemë e perime; • Peizazh dimri; • Poster (trafikimi i fëmijëve). 	<p>○ <i>Vizatim e ngjyrosje-7 orë, (lapsi i butë, ngjyra druri, flomasterë, ngjyra e uji, ngjyrat paste, ngjyra tempero, etj.).</i></p>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfitojnë disa nuanca të ngjyrave dhe dallojnë llojet dhe teknikat punuese me ngjyra. • Përfitojnë shkathtësi krijuese me anë të ngjyrave. • Krijojnë punime nga llojet e ngjyrave.

<p>• Materialet dhe puna tridimensionale (4 orë)</p>	<p>Aplikimi dhe përshtatja e punëve në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Temave atraktive tredimensionale (skulpturale) si: • Lodra ime, • Pallati mbretëror, • Piramidat, • Temë e lirë. 	<p>○ <i>Material punues për forma tridimensionale-4 orë, (karton, kuka të ndryshme, tel i butë, pambuk, ngjitës etj.)</i></p>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aplikojnë së paku dy punime me forma të ndryshme skulpturale.
---	--	---	--

III. Analiza dhe vlerësimi

- **Udhëzim:** Kjo kategori mësimore këtë vit shkollor përmbledh njohuritë paraprake për komponentet, veçoritë dhe përshkrimin komentues të degëve të artit pamor si dhe rrit aftësinë e komunikimit të nxënësve për vlerësim.

Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime	Rezultatet e pritshme
<p>• Komponentet figurative (3 orë)</p>	<p>Njohja me komponentet e artit figurativ:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtpeshimi me forma; • Drejtpeshimi me ngjyra; • Drejtpeshimi me dritë-hije; 	<p>○ <i>Mësimi teorik për komponentet përbërëse të veprave figurative dhe realizimi i punimeve në bazë të këtyre parimeve – 3 orë</i></p>	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë komponentet figurative dhe krijojnë një punim përkatës.

<p>• Veçoritë e artit figurativ dhe aplikativ (6 orë)</p>	<p>Njohuri tematike për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë e artit figurativ: (Vizatimi, piktura, skulptura, grafika etj.). • Veçoritë e artit të aplikuar: (Reklama, poster, ilustrimi, shenja identifikuese, dizajni në industri, qeramika, tekstili, tapiseria, arkitektura, fotografia etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Mësim teorik për ndarjen dhe veçoritë karakterizuese të artit-2 orë.</i> ○ <i>Demonstrim konkret dhe punë praktike me shembuj nga fusha e artit figurativ e aplikativ-4orë, (demonstrim me punime, fotografi, fotosllajde, videoprojektim, internet etj).</i> 	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregojnë specifikat e degëve të artit figurativ. • Të jenë në gjendje të bëjnë dallimin e punimeve të artit figurativ sipas degëve.
<p>• Përshkrimi figurativ (2 orë)</p>	<p>Përshkrimi figurativ sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimit personal; • Përshkrimit interaktiv; 	<ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Komentet e nxënësve përballë veprave të tyre dhe artistëve më të njohur – 2 orë.</i> 	<p>Nxënësit do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruajnë ndonjë vepër të punuar ose nga literatura.

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

- Edukata figurative ka qasje ndërlëndore e programore, me të gjitha lëndët e tjera mësimore. Përshkrimet ilustrative në tekste dhe mjete të tjera mësimore, u ndihmojnë nxënësve t'i kuptojnë më lehtë njësitë mësimore.
- Kjo lëndë ka qasje të ngushtë ndërlëndore e programore me gjuhën shqipe, matematikën, njeriu dhe natyra, punë-doren, muzikën, edukimin qytetar, edukatën fizike etj.
- Edukata figurative është lëndë gjithpërfshirëse dhe përmes saj, të kuptuarit logjik mund të aplikohet në procesin mësimor dhe përmes imazheve figurative vetëdijësojnë nxënësit: për të drejtat e fëmijëve, ruajtjen e mjedisit, të drejtat gjinore, të drejtat racore, trafikimin e të rinjve dhe dukuritë e tjera negative në shoqëri.

UDHËZIME E REKOMANDIME PËR PUNË PRAKTIKE

- Mësimdhënësi, duhet të jetë aktiv gjatë orës mësimore me nxënësin në qendër, në mënyrë që të vëzhgojë dhe të korrigjojë aktivitetin e nxënësve dhe punën e tyre kreative.
- Shkolla duhet të sigurojë së paku hapësirën ekspozuese për punimet më të suksesshme të nxënësve, në mënyrë që inspirimi dhe motivimi për pjesëmarrje në këto përvoja të mbështetet në suksese dhe aktivitete të larmishme.
- Aplikimi i punës individuale dhe në grupe, do t'i motivojë nxënësit për bashkëpunim, tolerancë e disiplinë kolektive.
- Gjatë punës me nxënës, do të ketë dallime evidente në kuptimin e talentit të tyre, por mësimdhënia pedagogjike me udhëzime e rekomandime praktike do t'i inspirojë edhe nxënësit më pak të talentuar, në mënyrë që të mos ndodh demoralizimi dhe shkëputja e tyre nga lënda mësimore.
- Mësimdhënësi dhe shkolla duhet të angazhohen për pajisjen e kabineteve (klasëve), veglave dhe mjeteve të tjera për konkretizim.

VLERËSIMI

- ❖ Vlerësimi i rregullt dhe matja e kujdesshme e përparimit të nxënësve gjatë mësimit figurativ nxit dhe motivon përkushtimin e tyre më të madh në arritjen e rezultateve sipas objektivave të parashtruar.
- ❖ Meqenëse vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë kryesisht bëhet duke u mbështetur në komunikimin e tyre verbal, mësuesi duhet të ketë parasysh edhe angazhimin e nxënësve për njohuritë e tjera teorike dhe komentuese.
- ❖ Për këtë lëndë, vlerësimin objektiv duhet kërkuar në bazë të arritjeve nga:
 - Kreativiteti individual i shprehjes së lirë në zotërimin e trajtave më të sakta nga detyrat e parashtruara;
 - Aktiviteti dhe përfshirja e nxënësve në punë individuale dhe grupore ose ekspozita të ndryshme (shkollore);
 - Origjinaliteti dhe qasja përkushtuese në përfundimin e punimeve.
 - Përdorimi i fjalorit figurativ gjatë vlerësimit të veprave autoriale dhe njohja e drejtimeve dhe komponenteve të tjera teorike.

TEKSTET DHE MJETET E TJERA MËSIMORE

Me qëllim të lehtësimit të procesit mësimor, përveç teksteve mësimore, të mirëseardhura janë edhe:

Mjetet dhe materiali tjetër mësimor, si:

- Literaturë shtesë nga artet figurative;
- Revista, fotografi, ilustrime, simbole, posterë, piktura etj;
- Fotosllajde, kompakt disqe (CD), kaseta etj.);
- Adresa në internet (www.art_attack.com , www.toggo.de etj);
- Modele të ndryshme (lojëra, kukulla-modele, makete, forma gjeometrike etj.);
- Lloje të letrave me gramaturë e ngjyra të ndryshme;
- Lloje të ngjyrave (lapsa, akuarel, temper, pastel etj.);
- Brusha, ngjitës, gërhërë, plastelinë, kube të ndryshme, sapunë, tel të butë, lloje tekstilësh etj.

PUNËDORE

(1 orë në javë, 37 orë në vit)

HYRJJE

Aktivitetet e teknologjisë kanë gjetur zbatim në shumë aspekte, si në jetën personale, në shtëpi, në shkollë, për zbavitje, në rrethinën ku jetojmë, për prodhimin e energjisë, biznes dhe industri. Shkollat mund të fusin në programet shkollore të gjitha këto aspekte sipas një organizimi parimor. Këto aspekte mund të kombinohen në mënyra të ndryshme ndërmjet vete me qëllim zhvillimi të aftësive krijuese dhe komunikuese.

Lënda puna e dorës kombinon punën e dorës me atë mendore duke bërë që të rritet aftësia krijuese, kurioziteti, marrja e përgjegjësive dhe aftësia për të zgjidhur problemet te nxënësit. Punimi i realizuar nga nxënësit fillon me idenë dhe përfundon me produktin e gatshëm. Punimi me tekstil, dru apo metal ose material tjetër, ka për qëllim t'u rrisë nxënësve besimin në aftësitë e tyre dhe t'i përgatisë ata për të menaxhuar punët e përditshme në jetë.

Lënda punë dore ka si qëllim të njohë nxënësit me vlerat estetike si dhe t'u mësojë atyre se përzgjedhja e materialit, përpunimi dhe montimi ndikojnë në funksionimin dhe në jetëgjatësinë e prodhimit. Kjo lëndë ofron njohuri për problemet që kanë të bëjnë me mjedisin dhe ruajtjen e tij si dhe rëndësinë e menaxhimit të mirë të burimeve materiale.

Nga një këndvështrim më i gjerë kjo lëndë synon t'i ruajë traditat e punës së dorës (artizanale) në kultura të ndryshme.

Punë dore për klasën e pestë ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme nga fusha e vizatimit teknik, teknologjia e materialeve ndërtimore, përdorimi i pajisjeve teknike, shkathtësitë e të punuarit, teknologjia e prodhimeve bujqësore, trafiku dhe teknologjia e informimit dhe komunikimit që parashihen për këtë nivel.

Teknologjia e prodhimeve bujqësore përfshin të kuptuarit dhe përdorimin e proceseve të sigurta dhe të besueshme për prodhimin, përgatitjen,

prezantimin dhe ruajtjen e ushqimit, si dhe zhvillimin, paketimin dhe marketingun e ushqimeve.

Përdorimi i pajisjeve teknike përfshin diturinë për përdorimin e pajisjeve teknike, funksionimin e tyre, si dhe kujdesin për mirëmbajtje dhe mbrojtje gjatë punës me to.

Teknologjia e materialeve ndërtimore përfshin identifikimin, përdorimin dhe zhvillimin e materialeve për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Kjo nënkupton dituritë për sasi të dhe përshtatshmërinë e materialeve ndërtimore, si argjila, gjipsi, çimentoja dhe stiropori, si dhe për procesin për përpunimin e tyre.

Vizatimi dhe grafikati janë gjithashtu thelbësore për praktikën teknologjike për përcaktimin dhe sqarimin e ideve dhe zgjidhjeve të propozuara.

Trafiku ka të bëjë me njohjen e pjesëve përbërëse të biçikletës si dhe njohuritë dhe zbatimin e rregullave të biçiklistit në praktikë.

QËLLIMET

Qëllimet kryesore të punës së dorës të nxënësit janë:

- Zhvillimi i një shprehje pozitive të nxënësit ndaj shprehjes në punë dore dhe rëndësisë së saj.
- Njohja e relacioneve në mes të teknologjisë dhe shoqërisë – tash, në të kaluarën dhe në të ardhmen.
- Inkurajimi i nxënësve për të marrë ndonjë nisativë dhe veprim të pavarur, duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grupe, në vartësi prej llojeve të ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë.
- Identifikimi, përdorimi dhe të kuptuarit e prodhimeve, sistemeve dhe të mjediseve teknologjike të zhvilluara në shoqërinë e tyre.
- Identifikimi i nevojave dhe i mundësive që mund të arrihen me ndihmën e aktivitetit teknologjik.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kuptimin e përparësive dhe kufizimeve që i ofron lënda.

- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, me nisëativë, etj.).

Të njohë

- Elementet e vizatimit teknik.
- Veprimet që përfshihen në teknologjinë e përpunimit të perimeve dhe të frutave.

Të kuptojë

- Rëndësinë e përdorimit të materialeve ndërtimore.
- Rëndësinë e përpunimit të prodhimeve bujqësore.
- Përdorimin e pajisjeve teknike.

Të përshkruajë

- Mënyrën e përdorimit të pajisjeve teknike.
- Mënyrën e përpunimit teknologjik të prodhimeve bujqësore.
- Mënyrën e përpunimit teknologjik të materialeve ndërtimore.

Të zbatojë

- Rregullat e përdorimit të pajisjeve teknike.
- Rregullat e biçiklistit në trafik

Të dallojë

- Pajisjet e ndryshme teknike.
- Pjesët kryesore përbërëse të kompjuterit.

Të modelojë

- Objekte nga materialet ndërtimore.

Të demonstrojë shkathtësi mendore

- Të ketë besim në vetvete dhe të rrisë besimin në aftësinë e tij për punë artizanale.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja
1. Vizatimi teknik	1.1 Elementet e vizatimit teknik 1.2 Paraqitja e trupave nëpërmjet vizatimit teknik	4	10,81%
2. Teknologjia e materialeve ndërtimore	2.1 Argjila 2.2 Gjipsi 2.3 Çimentoja 2.4 Stiropori	4	10,81%
3. Mjetet dhe pajisjet teknike	3.1 Përdorimi i mjeteve dhe i pajisjeve teknike	4	10,81%
4. Shkathësitë e të punuarit	4.1 Zgjedhja dhe përdorimi i metodave përkatëse të përpunimit dhe formimit të materialeve	9	24,33%
5. Teknologjia e prodhimeve bujqësore	5.1 Teknologjitë e kultivimit dhe përpunimit të bimëve 5.2 Blegtoria dhe teknologjitë blegtorale 5.3 Ekonomia bujqësore	8	21,62%
6. Trafiku	6.1 Biçiklisti në trafik	4	10,81%
7. Teknologjia e Informimit dhe e Komunikimit	7.1 Njohuri të përgjithshme për kompjuterin 7.2 Puna me programe	4	10,81%

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme Nxënësi duhet të jetë në gjendje:	Lidhja ndërlëndore
1. Vizatimi teknik	1.1 Elementet e vizatimit teknik	1.1.1 Skica 1.1.2 Llojet e vijave 1.1.3 Kuotimi 1.1.4 Përpjesa	Të njohë elementet e vizatimit teknik. Të kuptojë llojet e vijave, kuotimin, përpjesën.	Matematikë, Arte të bukura.
	1.2 Paraqitja e trupave nëpërmjet vizatimit teknik	1.2.1 Mjetet teknike 1.2.2 Paraqitja e trupave	Të zbatojë elementet e vizatimit teknik gjatë paraqitjes së trupave.	
2. Teknologjia e materialeve ndërtimore	2.1 Argjila	2.1.1 Argjila si material për ndërtimtari. 2.1.2 Zbatimet e ndryshme të argjilës në ndërtimtari.	Të identifikojë zbatimet e ndryshme të argjilës.	Gjuhë amtare, Arte të bukura.
	2.2 Gjipsi	2.2.1 Gjipsi si material për ndërtimtari. 2.2.2 Zbatimet e ndryshme të gjipsit në ndërtimtari.	Të identifikojë zbatimet e ndryshme të gjipsit.	
	2.3 Çimentoja	2.3.1 Çimentoja si material për ndërtimtari. 2.3.2 Zbatimet e ndryshme të çimentos në ndërtimtari.	Të identifikojë zbatimet e ndryshme të çimentos.	
	2.4 Stiropori	2.4.1 Stiropori si material për ndërtimtari. 2.4.2 Zbatimet e ndryshme të stiroporit në ndërtimtari.	Të identifikojë zbatimet e ndryshme të stiroporit.	

3. Mjetet dhe pajisjet teknike	3.1 Përdorimi i mjeteve dhe i pajisjeve teknike	3.1.1 Përdorimi i drejtë i mjeteve: limës, shënuesve të ndryshëm, darave, etj., si dhe pajisjeve teknike: sharrës së dorës, turrjlës, shpuesës elektrike, mengënës, etj.	Të dallojë mjetet dhe pajisjet e ndryshme teknike. Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve teknike. Të zbatojë rregullat e përdorimit të tyre.	Gjuhë amtare, Arte të bukura, Matematikë.
4. Shkathtësitë e të punuarit	4.1 Zgjedhja dhe përdorimi i metodave përkatëse për përpunimin dhe formimin e materialeve	4.1.1 Puna e pavarur e objekteve të ndryshme nga argjila, gjipsi, çimentoja, stiropori etj.	Të zhvillojë aftësitë e përpunimit me dorë dhe me makina themelore të argjilës, gjipsit, çimentos, stiroporit etj. Realizimi bëhet përmes projektit.	
5. Teknologjia e prodhimeve bujqësore	5.1 Teknologjitë e kultivimit dhe përpunimit të bimëve	5.1.1 Kultivimi i bimëve 5.1.2 Përpunimi i prodhimeve lavërtare 5.1.3 Përpunimi i perimeve dhe i frutave	Të njohë materiet ushqyese që përbëjnë prodhimet lavërtare. Të njohë veprimet që përfshihen në teknologjinë e përpunimit të perimeve dhe të frutave.	Gjuhë amëtare, Dituri natyre.
	5.2 Blegtorja dhe teknologjitë blegtorale	5.2.1 Teknologjia e përpunimit të mishit 5.2.2 Teknologjia e përpunimit të mjaltit	Të njohë teknologjinë për përpunimin dhe konservimin e mishit. Të njohë teknologjinë e përpunimit të mjaltit.	
	5.3 Ekonomia bujqësore si	5.3.1 Rëndësia ekonomike e furnizimit me prodhime bujqësore	Të njohë rëndësinë e industrisë përpunuese për shfrytëzim	

	sistem bujqësor		racional të prodhimeve bujqësore.	
6. Trafiku	6.1 Bëqiklisti në trafik	6.1.1 Bëqikleta dhe pjesët e saj 6.1.2 Rregullat e bëqiklistit 6.1.3 Mirërmabjtja e bëqikletës 6.1.4 Vozitja në poligonin shkollor	Të njohë pjesët përbërëse të bëqikletës. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e bëqiklistit në praktikë.	Edukatë fizike
7. Teknologjia e informimit dhe e komunikimit	7.1 Njohuri të përgjithshme për kompjuterin	7.1.1 Njësitë përbërëse të kompjuterit. 7.1.2 Zbatimi i kompjuterëve në jetën e përditshme	Nxënësit duhet të njihen me kompjuterin duke bërë identifikimin e pjesëve përbërëse të tij. Nxënësit duhet të njihen me mundësitë e zbatimit të kompjuterëve në jetën e përditshme, nëpërmjet rasteve konkrete.	Gjuhë amtare, Gjuhë angleze.
	7.2 Puna me programe	7.2.1 Kalkulimet matematikore me kompjuter. 7.2.2 Ekzekutimi i audio dhe video materialeve me kompjuter, etj. 7.2.3 Ekzekutimi i lojërave me kompjuter, etj.	Nxënësit duhet të bëjnë veprime të drejtpërdrejta në kompjuter duke përdorur programe konkrete, siç janë: programi calculator , programet për ekzekutimin e këngëve, filmave, lojërave të ndryshme, etj.	

VLERËSIMI

Vlerësimi i të nxënësve bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësve gjatë realizimit të përmbajtjes programore;
2. Vlerësimi i punës individuale;
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore.

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

Literatura e propozuar

1. Doracakë për punën me argjilë, gjips, çimento, stiropor etj.
2. **Erich Neuwirth**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 2”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2001.
3. **Schoiswohl · Jeide · Neuwirth** : “Spaß beim Forschen und Entdecken 3”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2002.
4. **Schoiswohl · Jeide · Vogl**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 4”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2003.
5. **Rexhep Berisha**: “Arsimi teknik”, klasa V, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001.

Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme

1. Trajnime për arsimtarë
2. Kabineti i pajisur me materiale dhe mjete të konkretizimit

Kushtet minimale

1. Trajnime për arsimtarë

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME METODOLOGJIKE

1. Qasja problemore në paraqitjen e temës/njesisë;
2. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore;
3. Inkurajimi i punës individuale dhe i shkëmbimit të dijes dhe shkathtësive, puna interaktive.

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

1. Puna grupore dhe individuale

EDUKATË FIZIKE DHE SPORTIVE

(2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Për mësimdhënës të mësimit klasor, procesi i Edukatës fizike dhe sportive më nxënës të klasës V-të paraqet veprimtari shtuese dhe të vështirë, me përgjegjësi të madhe, sepse ka të bëjë me ruajtjen dhe me kultivimin e shëndetit në fazën më kritike të zhvillimit të organizmit të fëmijës.

Në këtë aspekt duhet pasur aftësi-dijeni profesionale të begatshme, sepse me reformë të re të arsimit kërkohet që mësimdhënësit e mësimit klasor procesin mësimor ta organizojnë edhe nga kjo lëndë.

Me organizim të drejtë të orëve mësimore si dhe të atyre jashtëshkollore, duke u mbështetur në kërkesat didaktiko-metodike do të arrihet që procesi mësimor të ketë sukses duke ndikuar te nxënësit që të formojnë botëkuptimin e drejtë për vlerën dhe rëndësinë e kësaj shkathtësie që ajo e ka në ruajtjen dhe në kultivimin e shëndetit.

Me organizim të drejtë të procesit mësimor të Edukatës fizike dhe sportive duke u shfrytëzuar format e ndryshme të punës, do të arrihet:

- zhvillimi normal dhe adaptimi i organizmit në kushte të ndryshme të jetës, përvetësimi i vetive pozitive-edukative si dhe atyre motorike;
- mbrojtja dhe zhvillimi i aftësive biologjiko-higjienike duke kontribuar në ruajtjen dhe në kultivimin e shëndetit;
- përgatitja-aftësimi i organizmit të nxënësit për përvetësimin e përmbajtjeve programore, duke arritur që me sukses të bëhet eliminimi i pengesave që do të paraqiten, eventualisht, në aftësitë lëvizore;
- Do të arrihet aftësimi maksimal në aspektin e mjeshtërisë motorike duke u orientuar në zgjedhjen e sportit për të cilin ka afinitet.

QËLLIMI

Për nxënësit e klasë V-të, qëllimi i Edukatës fizike dhe sportive është që duke e zbatuar sipas kërkesave didaktiko-metodike, të arrihet plotësimi i kërkesave bio-psiko-sociale, duke e kuptuar vlerën dhe rëndësinë e kësaj shkathtësie që ajo e ka në mënyrë permanente gjatë tërë jetës.

Sipas përmbajtjeve programore të përfshira në këtë plan dhe program, duhet të arrihet:

- njohja e thelbit dhe vlerës së Edukatës fizike dhe sportive;
- të nxitë zhvillimim harmonik dhe të mbajtjes së drejtë të trupit;
- të nxitë zhvillimin e kulturës shëndetësore më qëllim të mbrojtjes më efikase të shëndetit;
- të nxitë dhe të aktivizojë aftësitë latente si dhe aftësitë motorike për përsosjen e elementeve tekniko-taktike të sporteve dhe të vallëzimit;
- përjetim i këndshëm dhe pozitiv i edukimit fizik dhe sportiv;
- të respektohet kultura dhe të arriturat shoqërore dhe kombëtare;
- të krijohen shprehje për vetveprimtarinë humanitare dhe shoqërore;
- nxitja dhe inkurajimi për nisativë dhe veprim të pavarura duke i pasur parasysh parimet themelore të Edukatës fizike dhe sportive.

OBJEKTIVAT

Duke i realizuar përmbajtjet programore të dedikuara për nxënësit e klasë së pestë, janë paraparë të arrihen objektivat:

- **zhvillimi trupor, i aftësive motorike dhe funksionale;**
- **fitimi i diturive dhe përsosja i lëvizjeve natyrore;**
- **njohja e vetive teorike të Edukatës fizike dhe sportive;**
- **gjatë të ushtruarit përjetimi i këndshëm i edukimit fizik dhe sportiv.**

Zhvillimi trupor, i aftësive motorike dhe funksionale:

- të ndikohet dhe të ruhet të mbajturit e drejtë të trupit;
- të vazhdohet me ndikim maksimal në zhvillimin e aftësive motorike;
- përvetësimi dhe përsosja e aftësive orientuese në hapësirë, duke i shfrytëzuar dhe përvetësuar pozitativat e ndryshme të trupit;
- përvetësimi dhe përsosja e elementeve ritmike dhe të vallëzimit;

- përsosja dhe zhvillimi i aftësive funksionale të organeve të organizmit të nxënësve;
- kultivimi dhe ruajtja e aftësive individuale, duke i plotësuar motivet parësore të nxënësve që nevojiten për lojë dhe lëvizje themelore;
- ruajtja, kultivimi dhe përvetësimi i shprehive higjienike më qëllim të ruajtjes së shëndetit të nxënësve, duke u adaptuar kushteve të jetesës.

Fitimi i diturive dhe përsosja e lëvizjeve natyrore:

- përsosja dhe përkryerja e komponimeve të elementeve të ndryshme sportive;
- të aftësohen të dinë të dallojnë dhe të shfrytëzojnë rekuizitat sportive;
- të përvetësohet drejt teknika e vrapimeve, kërcimeve dhe hedhjeve;
- të përvetësohet drejt teknika e ekzekutimit të elementeve bazë nga gjimnastika sportive dhe ritmike, duke i kombinuar disa elemente (lidhja e dy-tre elementeve);
- përvetësimi i rregullave të lojërave sportive;
- përvetësimi, së paku i një stili të notit;
- përvetësimi i elementeve bazë të skijimit dhe lidhshmëria e tyre sipas terrenit.

Njohja e vetive teorike të Edukatës fizike dhe sportive:

- Njohja e nocioneve të mjeteve dhe të rekuizitave sportive si dhe mënyra e shfrytëzimit;
- njohja e nocioneve themelore të shprehjes sportive;
- njohja teorike e vlerës së Edukatës fizike dhe sportive;
- njohja dhe respektimi i rregullave të lojërave gjatë garave dhe sjellja korrekte dhe humane ndaj kundërshtarit;
- Njohja themelore e vetive të lëvizjeve trupore dhe ndikimi i tyre në transformimin e organizmit të nxënësve;
- Njohja dhe respektimi i kushteve higjienike individuale dhe shoqërore.

Gjatë të ushtruarit, përjetimi i këndshëm i Edukatës fizike dhe sportive:

- Ndikim në zhvillimin e vetive pozitive-sjelljes sportive, bashkëveprim dhe përgatitje, kolektivitet gjatë garave, zhvillimi i garave në bazë të rregullave;

- përjetim i drejtë dhe i këndshëm si ndaj fitores, ashtu edhe ndaj disfatës;
- ndikim në aftësimin e qëndrueshmërisë, vetnisiativës, guximit, korrektësisë, çiltësisë;
- përjetimi i këndshëm i kushteve dhe i rregullave higjienike gjatë të ushtruarit dhe garave-lojërave;
- përmes aktiviteteve trupore të arrihet motivimi i nxënësve për të ushtruar në bazë të kërkesave didaktiko-metodike;
- të arrihet që nxënësit duke ushtruar të përjetojnë kënaqësi estetike dhe ritmike.

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

Kategoritë	Nnkategoritë	Nr. orëve dhe %
Testimi: zhvillimi trupor dhe aftësitë motorike	Matja e lartësisë trupore dhe pesha-kërcim së gjati nga vendi, - qëndrim më krahë të mbledhur në shufrën e hekurit, - përkulja e thellë në bankë - dhe vrapim 200, 400 dhe 600m.	4 orë 5.40%
ATLETIKË	- vrapimet, - kërcimet dhe - hedhjet	17 orë 23%
Gjmnastika dhe ritmike	- ushtrime në dysheme, - kërcimet, - hekuri, - pralelet, - unazat, - trari gjmnastikor, - ushtrime ritmike me valle,	17 orë 23%
Sportet kolektive:	- futboll i vogël, - hendboll, - basketboll, - volejball,	25 orë 33.75 %
Sportet individuale	- karate, - pingpong, - tenis	11 orë 14.85 %
Aktivitetet e tjera	- ushtrime formimi, - shëtitjet dhe krosi, - dimërimi dhe verimi	
Vlerësimi:	- permanent, - periodik dhe - përfundimtar	

TREGUESIT THEMELORË TË PROGRAMIT

Kategoritë	Nënkategoritë	p. programore	St.arit.
Testi	Matja dhe vlerë-imi i veçorive antropometrike Aftësive lëvizore-motorike	Pesha e trupit, lartësia trupore, hedhja e mediciballit-kërcim së gjati nga vendi, - qëndrim me krahë mbledhur në hekur (sek) - vrapim 200m (m.f),vrapim 600m (M) dhe 400m (F)	Shkalla përfundimtare dhe fillestare e zhvillimit të organizmit.
Atletikë	Vrapim	<ul style="list-style-type: none"> - përforcim të teknikës së vrapimit sipas largësive dhe tempit të ndryshuar si dhe të lojërave themelore të përvetësuara në kl. IV. - teknika e startit të lartë dhe të ulët, - vrapim i shpejt në distancë 60-100 m. - teknika e vrapimit në largësi 100, 200, 400, 600 m. - teknika e vrapimit dhe ecjes me kohë zgjatje 2 min. (me pushim) - lojërat e stafetës më rekuizita të ndryshme (rrathë, shkopinj, shishe druri, topa, shkopinj etj.) 	Të përvetësojnë teknikën e vrapimit sipas kushteve dhe të tempit. Të dijnë teknikën e startit të lartë dhe të ulët si dhe të fitojnë shprehi për reagim të shpejtë-daljes nga starti si dhe adaptimi i hapave të vrapimit sipas terrenit dhe largësive e kohës së zgjatjes.
	Kërcimet	<ul style="list-style-type: none"> - kërcim së gjati teknika “trupi në hark dhe mbledhur“- - kërcim së larti teknik „gërsherë“ dhe barkush. 	Të fitojnë shprehi për ekzekutimin e teknikave të kërcimeve-së gjati dhe së larti-teknikat;
	Hedhjet	- Hedhja e tophave 200gr. Në gjatësi dhe në cak.	Të arrihet shprehi në të vërejtur dhe saktësi.

Gjymnastika sportive dhe ritmike	Ushtrime në dysHEME	- përsëritja dhe përforcimi i elementeve të përvetësuar në kl. IV (kapërdim para, mbrapa, nga pozitat e ndryshme). - kapërdim fluturimthi, - vertikalia mbi duar,-rrotullimi anësor, -ekuilibri anësor dhe ballor (kombinim i elementeve në një kompleks 3 e më shumë)	Të përsosin dhe të dinë ekzekutimin e drejtë të elementeve në kuadër të lidhjeve-dy e më tepër elemente
	Kërcimet	- përsëritja e kërcimit të kaluqit me këmbë hapur dhe mbledhur.	Përsosja e teknikave të kërcimeve
	Hekuri	- varje e përzier dhe përgatitja për varje në gropën e gjurit.	Të dinë të dallojnë pozitat e trupit në varje
	Paralelja	- mbështetja në duar dhe nga lëkundja dalje mbrapa.	Përvetësimi i teknikave të elementeve përkatëse dhe ekzekutimi i drejtë.
	Paralelja e shkallzuar	Varje e përzier - përgatitje për rrotullim para në drushtën e ulët.	Të kuptojnë dhe të dinë të dallojnë varjet që shfrytëzohen në unaza dhe në vegla të tjera.
	Unazat	- varje e shtrirë, - varje e palosur nga varja e shtrirë kalim në varje të palosur.	- të dallojnë ritmin sipas lëvizjeve me rekuizita si dhe muzikën përkatëse të lëvizjeve ritmike.
	Ushtrime ritmike	Ushtrime ritmike me rekuizita (litar, shishe druri, shkopinj - sipas rekuizitave) - lojërat themelore me elemente të ushtrimeve ritmike -vallja popullore nga rrethi-mesi shoqëror.	
Sportet kolektive	Futbolli i vogël	Elementet bazë pa dhe me top (debllokimi, shërbimi, pasimi, prenimi, driblimi, gjuejtja etj.) - loja e thjeshtë 1:1, deri 2:2,3:3 ,5:5.	Përvetësimi i elementeve bazë tekniko-taktik më zbatim të rregullave të

	Hendboll	- elementet bazë tekniko-taktike (pasimi, marrja e topit nga pozita të ndryshme-anash, mbi kokë, në lartësi të supit, gjurit etj.). - driblimi me depërtim, - deblokimi i lojtarit pa top. - lojëra themelore më rregulla të hendbollit. - loja 1+3.	lojës ”
	Basketboll	- elementet bazë tekniko-taktike-driblim me ndërrim të kahut dhe të ritmit, me ndalje me njëren dhe me të dy duart. - pasimi dhe marrja (kapja) më të dy duart nga vendi dhe në lëvizje. - mbulimi i lojtarit të sulmit. -lojërat e stafetës, - lojërat themelore me detyra të ndryshme. - loja në një kosh-1:1, 2:2, 3:3 dhe 4:4.	”
	Volejboll	- elementet bazë tekniko-taktike, -lojërat themelore për zhvillimin e reagimit të shpejtë dhe të shpejtësisë, orientim në hapësirë dhe bashkëveprim. - lojërat e stafetës	”
Sportet individuale	Karate	Përvetësimi i elementeve fillestare të vetëmbrojtjes – pa kundërshtar	”
	Pingpong	Elementet bazë tekniko-taktike (kapja dhe mbajtja e reketit, lëvizja e këmbëve dhe duarve, goditjet e topit në forma të ndryshme-lirë). Goditja themelore (forhend dhe bekhend). loja elementare si dhe loja 1:1, 2:2-me rregulla elementare.	”

	Tenis	- elementet themelore (kapja dhe mbajtja e reketit, lëvizja e këmbëve dhe e krahëve. - goditjet themelore të topit (forma të lira, pastaj forhend dhe bekhend) shërbimi-. - loja themelore „topi sa më gjatë në lojë“ 1:1, 2:2, 3:3 etj. (sipas numrit të reketave) si dhe loja me rregulla themelore.	„
Aktivitetet e tjera	Ushtrimet e formimit	- kopleksi i ushtrimeve të formimit pa dhe me rekuizita e vegla (topa, rrathë, shkopinj, toptha, etj.) në çdo orë të mësimi.	Të aftësohen nxënësit që në çdo rast të shfrytëzojnë ushtrimet trupore.
	Shetitjet dhe krosi	Tri herë në vitë-vjesht, dimër dhe pranverë.	Të aftësohen që pa vështërsi ti përvetësojnë pengesat natyrore.
	Dimërmi	- lojëra themelore në borë. -elementet bazë të skijimit, - kthimi paralel, ecje dhe vrapim, shfrytëzimi i rekuizitave për rrëshqitje.	- të aftësohen që të dallojnë llojet e borës dhe të përvetësojnë teknikën bazë të pozitës së trupit në situata të ndryshme të rrëshqitjes etj.
	Verimi	Përvetësimi një ose dy teknikave të notit, duke zbatuar veprimet e krahëve, të këmbëve, - teknika e frymëmarrjes, - kombinimi i teknikave të krahëve me këmbë si dhe me frymëmarrje, - starti shkollor dhe kthimi.	- të përvetësojnë teknikën e stilit të notit që e ushtrojnë si dhe lojërat themelore në ujë.

VLERËSIMI

Nxënësit duhet të vlerësohen rregullisht nga ana e mësmdhënësit dhe atë në formë të vlerësimit:

- vlerësimit të aftësive fizike;
- vlerësimit të arritjeve tekniko-taktike (sportive) si dhe
- aktiviteti i vetëdijshëm i nxënësve ndaj edukimit trupor.

Që të arrihet vlerësimi i drejtë dhe objektiv, mësmdhënësi duhet të ketë njohuri për metodologjinë e përcjelljes së transformimit të organizmit të nxënësit në bazë të të cilës do të arrijë të caktojë shkallën e zhvillimit të aftësive të cekura më lart. Për këtë na shërbejnë bateria e testit të cekur në tabelën –TREGUESIT THEMELORË TË PROGRAMIT:

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME METODOGJIKE

Procesi i planifikimit dhe i programimit të Edukatës fizike dhe sportive kërkon aftësi profesionale si dhe përpjekje të vazhduar që të përfshihen të gjitha ato përmbajtje programore, të cilat me sukses do të realizohen gjatë zhvillimit dhe realizimit të procesit mësimor.

Për mësmdhënësi të mësimit klasor vështirësitë janë evidente gjatë programimit, sepse planifikimi dhe programimi sipas kërkesave didaktiko-metodike të kësaj lënde varet nga:

- kushtet tekniko-materiale të shkollës (objekti, poligoni sportiv, rekuizitat dhe veglat ndihmëse mësimore).
- dituritë (shkathtësitë) e fituara më parë.
- aftësitë bio-psiko-sociale të nxënësve.

Duke u bazuar në kushtet që shkollat tona i kanë planifikimi dhe programimi i përmbajtjeve programore nga ana e mësmdhënësve duhet bërë në bazë të kushteve reale që shkolla i ka. Në mungesë të kushteve optimale duhet planifikuar dhe realizuar ato përmbajtje programore të cilat do të ndikojnë në transformimin e përgjithshëm të organizmit të nxënësve. Kjo arrihet nëse mësmdhënësi ka aftësi didaktiko-metodike, duke i njohur format organizative të punës, metodat, parimet e planifikimit si dhe parimet mësimore.

Gjatë procesit mësimor kur mësimdhënësi shfrytëzon format organizative të punës e sidomos organizimin e orës mësimore duhet të jetë i aftë që t'i shfrytëzojë ato forma metodiko-organizative të punës sepse zbatimi i vetëm një forme të punës, në mënyrë permanente, për nxënë të kësaj moshe, më vonë do të bëhet monotone dhe do të mungoi motivimi dhe interesimi nga ana e tyre që me dëshirë të kyçen në procesin mësimor.

Mësimdhënësi, në vartësi nga kërkesat e nxënësve, duhet në mënyrë permanente dhe të saktë të caktojë kohën sa do të zgjatë për realizimin e tematikës programore, gjithashtu duhet caktuar radhitjen për realizimin e tematikave të tjera programore.

Në të gjitha rastet, kur bëhet përsëritja ose zhvillimi i njësisë mësimore, mësimdhënësi përveç përgatitjes praktike duhet bërë edhe përgatitjen teorike dhe në këtë aspekt t'i njoftojë nxënësit me vlerën dhe rëndësinë që kanë aktivitetet trupore (përmbajta programore) për ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të tyre.

LITERATURA

1. **B. Hasangjekaj** - Metodika e edukatës fizike, Prishtinë, 1998.
2. **B. Hasangjekaj** - Edukata fizike dhe sportive 1, Prishtinë, 2004.
3. **Grup autorësh**, Edukata fizike dhe sportive 2, Prishtinë, 2004.
4. **Grup autorësh**, Edukata fizike dhe sportive 3, në dorëshkrim – 2005.
5. **Planet dhe programet mësimore - kl: I, II, III, IV - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.**
6. **M. Koritnik** - 2000 lojëra, Prishtinë, 1998.
7. **M. Princ** - Metodika shkollëske shportne vzgoja, Lublana, 1995.
8. **Grup autorësh** - Lojërat didaktike në kopshtin e fëmijëve, Tiranë.
9. **Grup autorësh** - Edukata fizike në shkollë, Tiranë 1973.
10. **M. Koshniçar** - Edukata fizike e nxënësve të sh.f. kl. I-IV, Prishtinë, 1968.

Tirazhi: 2000 copë
Përgatiti për shtyp:
*SHTËPIA BOTUESE **LIBRI SHKOLLOR*** – Prishtinë
Shtypi:
Shtypshkronja ALFAPRINT – Prishtinë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

Plani dhe programi mësimor : për klasën e pestë fillore / {Krye-
redaktor Fehmi Ismajli}. - Prishtinë : Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e
Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : "Alfaprint"). - 164 f. ; 24 cm.

ISBN 9951-450-84-9